Të gjitha bizneset që regjistrohen për herë të parë lirohen nga taksat komunale për (2) dy vite, ndërsa gjinia femërore të cilat hapin biznes të ri lirohen nga taksa 4 vite. Çdo biznes i ri që ka të punësuar deri dhjetë persona lirohet nga taksat për (3) tri vite, kurse çdo biznes i ri që ka të punësuar mbi dhjetë persona lirohet nga taksat komunale për (5) pesë vite.

Subjektet afariste të cilat veprimtarinë e tyre e zhvillojnë më tepër se një lokal jashtë selisë paguajnë 60% të taksës së përcaktuar të secilit lokal veç e veç.

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik do t'i lëshoj aktvendimet mbi ngarkesat vjetore komunale për ushtrimin e veprimtarive të bizneseve të gjitha bizneseve Komunale, kurse obliguesit janë të detyruar që krahas pagesës së taksës për ngarkesën vjetore sipas nenit 16 të kësaj rregullore dhe aktvendimit të posaçëm, të dëshmojnë pagesën e këtij obligimi duke e prezantuar para shërbimeve tona të inspektoratit gjatë inspektimit.

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Pjesa 7

18. Taksat dhe gjobat për Shërbime Publike

Nr. i taksës, ngarkesave	Shërbimet/aktivitetet, taksat dhe gjobat	Vlera në € për m ²
Ndërhyrja pa leje në infrastrukturën publike		
18.1	Personi fizik	250.00 €
18.2	Personi juridik	1,000.00 €
Dëmtimi i rrugëve dhe trotuareve gjatë kryerjes së punëve të ndryshme ndërtimore		
18.3	Për 1 m ² dëmtim të asfaltit	150.00 €
18.4	Për 1 m ² dëmtim të gurëve kubza ose pllaka	100.00 €
18.5	Për dëmtim të trotuarit të pa asfaltuar (hapja e kanaleve në trotuar)	50.00 €
18.6	Dëmtimi i skajoreve m ²	40.00 €
18.7	Dëmtimi i rigollave m ²	40.00 €
18.8	Personat juridik apo fizik, të cilët gjatë punëve ndërtimore dëmtojnë rrugët, hapësirat-objektet tjera publike, janë të obliguar t'i evitojnë dëmet e shkaktuara në afat prej 5 ditësh, në të kundërtën gjobiten me shumën e vlerësuar për dëmin e shkaktuar sipas tarifave 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7	
Derdhja e ujërave në hapësirën publike dhe ujërave te zeza		
18.9	Personi fizik	80.00 €
18.10	Personi juridik	300.00 €
Shfrytëzimi pa leje i trotuareve dhe hapësirave tjera publike:		
	Vendosja e objekteve të vogla të përkohshme- sezonale, lëvizëse (aparate për akullore, tavolina, gjenerator, objekte reklamuese etj.)	
18.11	Personi fizik	50.00 €
18.12	Personi juridik	100.00 €
18.13	Objektet më të mëdha lëvizëse (gjeneratorë, kioskë, bankomatë, automjeteve për reklamim, Luna Park, etj.)	200.00 €
Gërvishtja, prerja, lakimi, ndotja ose dëmtimi në çfarëdo forme i objekteve me interes të përgjithshëm siç janë: kabinat telefonike, ndriçimi publik, shenjat e komunikacionit dhe mbrojtjen e rrethojave të drunjtëve dekorativ etj.		
18.14	Personi fizik	150.00 €
18.15	Personi juridik	300.00 €
18.16	Dëmtimi i bimëve dekorative nëpër parqe (këputja e luleve, gjetheve etj.)	40.00 €
18.17	Dëmtimi i drunjtëve dhe bimëve dekorative neper hapësirat publike	40.00
18.18	Dëmtimi i ulësve dhe pjesëve përcjellëse të parqeve (ndotja, thyerja dhe dëmtimet tjera)	50.00 €
18.19	Dëmtimi i rrethojave për mbrojtjen e gjelbërimit për m	50.00 €

18.20	Demtimi i tabelave digjitale ne rruget publike dhe te kthehet ne gjendjen e meparshme	1,000.00
Kalimi (shkelja) me këmbë ose me automjet nëpër sipërfaqet e gjelbëruara të parqeve dhe hapësirave të tjera të ndaluara publike		
18.21	Personi fizik	25.00 €
18.22	Personi juridik	200.00 €
Shërbimet		
18.23	Pranimi i kërkesave	5.00 €
Lejet për ndërhyrje në infrastrukture dhe hapësirë tjetër publike		
18.24	Leja për prerjen e asfaltit në rrugë dhe trotuare 1m ²	
18.25	Për persona fizik	20.00 €
18.26	Persona juridik	50.00 €
Ngarkesat për shfrytëzimin e sipërfaqeve Publike, detyrimi bazë është për shfrytëzimin e m ² , sipas zonave të qytetit. Vendosja e tezgave lëvizëse dhe kiosqeve dhe objekteve tjera të vogla, të përkohshme – sezonale, lëvizëse në të cilat kryhet veprimtaria (tregti, hotelieri) si dhe pajisjeve të caktuara teknike (gjeneratorë, ormane MDF e të ngjashme) taksa mujore.		
18.27	Zona I për m ²	10.00 €
18.28	Zona II për m ²	8.00 €
18.29	Zona III për m ²	6.00 €
Vendosja e mjeteve për akullore dhe mjete tjera të ngjashme – taksa mujore.		
18.30	Zona I për aparat	15.00 €
18.31	Zona II për aparat	10.00 €
18.32	Zona III	7.00 €
18.33	Vendosja e ormanëve MDF taksë vjetore	20.00 €
Vendosja e objekteve statiken hapsiren publike gjenerator bankomate dhe objekte tjera për çfarëdo aktiviteti afarist taksë vjetore për m ²		
Vendosja e stendave të hapura dhe lëvizëse për shitjen e librave jo shkollor caktohet taksa mujore.		
18.34	Zona I	10.00 €
18.35	Zona II	7.00 €
18.36	Zona III	4.00 €
Shfrytëzimi i hapësirës publike para objektit ne të cilën kryhen shërbime hoteliere – taksa mujore.		
18.37	Zona I për m ²	5.00 €
18.38	Zona II për m ²	4.00 €
18.39	Zona III për m ²	3.00 €
Ekspozimi i pllakateve (panove) reklamuese - Taksa vjetore për m ²		
18.40	Zona urbane	30.00 €
18.41	Zona jashtë urbane	20.00 €
18.42	Pllakatet (panot) reklamuese me ndriçim paguhen me taksë të shtuar	30%
18.43	Pllakatet (panot) reklamuese të cilat shfrytëzojnë ndriçimin publik tarifave duhet shtuar edhe shpenzimet e energjisë elektrike për objektin reklamues .	
18.44	Vendosja e reklamave elektronike – ekraneve taksë vjetore për m ²	150.00 €

18.45	Reklamimi i pijeve alkoolike dhe duhanit është i ndaluar	
18.46	Për shfrytëzime tjera të hapësirës publike- ekspozimi (reklamimi) për 1 m ² – taksa mujore.	10.00 €
18.47	Nëse shfrytëzimi reklamues bëhet më pak së 30 ditë shtohet vlera për	100 %
18.48	Nëse pllakati është shumë krahësh, paguhet për çdo krah të dukshëm.	
18.49	Nëse pllakati është i vendosur në pronë private (të vetën), por për objektiv ka reklamimin, pala paguan sipas pikave 19.52, 19.53, 19.54 dhe 19.55 me zbritje.	50%
Ngarkesat për organizimin e lodrave argëtuese, të fatit dhe lodrave argëtuese automatike të ndryshme, si dhe rekuizitave tjera sportive.		
18.50	Vendosja e aparateve për lojëra fati, lojëra argëtuese etj. Taksa mujore për çdo aparat sipas llojit	10.00 €
18.51	Shfrytëzimi i hapësirës publike për vendosjen e objekteve argëtuese (parqeve argëtuese – Luna Park). Taksa mujore për m ²	1.50 €
Shërbime tjera		
18.52	Leja për vendosjen e materialit ndërtimor në hapësirat publike për 24 orë	25.00 €
18.53	Taks për hedhjen e mbeturinave të ngurta në depon e mbeturinave të ngurta për (m ³)	0.50€
18.54	Leje për bllokim të rrugës – shiritit rrugor – trotuarit për 24 orë	25.00 €
18.55	Dëmtimi i drunjëve dekorativ nëpër hapësira publike të asfaltuara të qytetit	200 €
18.55	Vërtetimi i rendit të udhëtimit – Operatori transportues paguan taksën për një vit për 1km.	0.50 €
18.56	Pëlqimi për plotësimin e kushteve teknike për vend-parkimin e automjeteve transportuese për mallra dhe udhëtar	30.00 €
Parkingjet e rezervuara – tarifë mujore		
18.57	Në parkingjet e Komunës	40.00 €
	Në parkingjet publike në shirita të ndara të rrugëve – trotuareve	
18.58	Personi fizik	15.00 €
18.59	Personi juridik	25.00 €
Vendosja e bus-ndaljeve(Stacion për udhëtar) m ² taksë vjetore 2.00€		
Parkingu kohor për 1 orë		
18.60	Në parkingjet e KK-së	0.50 €
18.61	Në parkingjet publike në shirita të ndara të rrugëve – zona I	0.30 €
18.62	Në parkingjet publike në shirita të ndara të rrugëve – zona II	0.20 €
18.63	Pëlqim për zhvarrosjen (eksëhumacionin e kufomave), e mbetjeve të kufomës.	Lirohet
18.64	Vendosja e foltoreve telefonike(tarife mujore)	10.00 €

Leje për vendosjen e transmetuesve (antenave), me frekuenca të ndryshme dhe objekteve tjera të ngjashme, për nevoja të telefonisë mobile, fikse, televizionit, internetit e tjera të ngjashme, paguhet taksa vjetore (nga vlera e llogaritur e objektit):			
18.65	Zona Urbane		800.00 €
18.66	Zona Rurale		500.00 €
18.67	Pëlqim – për plotësimin e kushteve teknike për kyçje-qasje në infrastrukturën rrugore dhe pëlqime tjera		10.00 €
Kyçja ilegale në sistemin e ujësjellësit			
18.68	Personi fizik		500.00 €
18.69	Personi juridik		3,000.00 €
Taksa për dhënien e pëlqimit për kyçje në ujësjellës			
18.70	Për ekonomi familjare		50.00 €
18.71	Për subjekte afariste		100.00 €
18.72	Vendosja e kablllove nëntokësore dhe përvojave në metra gjatësi		
18.73	Zona urbane		0.30 €
18.74	Zona rurale		0.10 €
	Shtrirja e kablllove mbitokësore dhe përvojave në metër gjatësi		
	Zona urbane		0.10€
	Zona rurale		0.05€
18.75	Taksat për shfrytëzimin e infrastrukturës komunale për subjektet të cilat eksploatojnë dhe përpunojnë resurse natyrore – në vit		400.00 €
	Hedhja e kafshëve, shpezëve në hapësira publike		
18.76	Personi fizik		100.00 €
18.77	Personi juridik		300.00 €
	Prurja (bartja) e kafshëve nga një vend tjetër në territorin e Komunës së Hanit të Elezit		
18.78	Personi fizik		200.00 €
18.79	Personi juridik		500.00 €
18.80	Shfrytëzimi i hapësirës publike për vendosjen e objekteve argëtuese (parqeve argëtuese – Luna Park), kiosqeve të përkohshme, tendave për panaire. Taksa mujore për m2.	*Riemërtim i taksës 1.50 €	1.50 € Nga kjo taksë lirohen OJQ-të

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Pjesa 8

Shërbimet e shëndetësisë të nivelit parësor dhe inspektimeve (Udhëzimi Administrativ Nr.04/2007 – Bashkë pagesat nga shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore dhe Udhëzimit Administrativ nr.04/2013 Çertifikatat Shëndetësore)

19.3. Taksat e pagesave për shërbimet shëndetësore të nivelit parësor

Nr.	Lloji i shërbimit	Vlera në €
1	Ekzekutimi mjekësor në punkt. QMF ose në QKMF , pa analiza laboratorike ose pa procedura plotësuese diagnostike me aparaturë	1.00 €
2	Ekzaminimi specialistik në QMF/QKMF me udhëzim të Mjekut të Familjes	2.00 €
3	Ekzaminimi specialistik në QMF/QKMF pa udhëzim të Mjekut të Familjes	5.00 €
4	Ekzaminimi në shtëpi , përpos në raste emergjente	6.00 €
5	Medikamenti nga lista esenciale , ofruar në barnatoren publike	0.30 €
6	Ultrazëri standard	2.00 €
7	Radiografia	2.00 €
8	EKG	0.50 €
9	Analizat laboratorike-vetëm hemogrami dhe urina	1.00 €
10	Analizat laboratorike (komplet) CRP dhe HbA1C	3.00 €
11	Përcaktimi i T-3, T-4 dhe TSH	5.00€
12	Caktimi i sheqerit në gjak me glikometër sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	1.00 €
13	Audiograma	1.00 €
14	Shpëlarja e veshit	1.00 €
15	Dhënia e injeksionit intramuskular në shtëpi,përpos rasteve emergjente	1.00 €
16	Dhënia e injeksionit intravenoz në shtëpi ,përpos rasteve emergjente	1.00 €
17	Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrimi deri në shërim të plagës(vetëm në vizitën e parë)	3.00 €
18	Trajtimi ditor me infuzione në institucionin shëndetësorë	1.00 €
19	Çertifikata shëndetësore për punësim	15.00 €
20	Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimi apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore.	5.00 €
21	Ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktiviteteve sportive, etj. Për një orë.	25.00 €

19.4 Taksat për shërbimet stomatologjike në nivelin parësor.

Nr.	Emërtimi	Vlera në €
1	Vizita e parë stomatologjike	1.00 €
2	Rtg i dhëmbit	1.50 €
3	Mbushje e përhershme me amalgam	4.00 €
4	Mbushje e përhershme me kompozitë	5.00 €
5	Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	5.00 €
6	Amputimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	6.00 €
7	Extirpimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	6.00 €
8	Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	6.00 €
9	Extirpimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	6.00 €
10	Terapia e kanalit të infektuar me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	6.00 €
11	Rindërtimi konservativ i dhëmbit me mbushje të përhershme të dhëmbit	6.00 €
12	Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjës	1.00 €
13	Fluorizimi i dhëmbëve sipas seancës	1.00 €
14	Vulosja e fisurave	1.00 €
15	Mënjanimi i depozitimeve të buta	1.00 €
16	Mënjanimi i depozitimeve të forta(heqja e gurzëve të dhëmbëve me ultratingull)	3.00 €
17	Kiterzha e xhepave parodontal(një dhëmbi)	1.00 €
18	Nxjerrja e dhëmbit	1.50 €
19	Incizioni intra dhe extra oral	1.50 €
20	Heqja e kurorës me anë të prerjes	1.00 €
21	Riparimi i protezës(ngjitja)	1.50 €

19.5. Taksat e QPS –së

Nr.	Lloji i vërtetimit	Në Euro
1	Vërtetim për humbjen e shtetësisë së Kosovës	5.00 €
2	Vërtetim për fitimin e shtetësisë së Kosovës	5.00 €
3	Vërtetim që nuk i është hequr zotësia e punës dhe e veprimit	3.00 €
4	Vërtetim që nuk është shfrytëzues i ndihmave sociale	3.00 €
5	Pëlqimi për martesë para moshës madhore	5.00 €
6	Kërkesë për regjistrim të mëvonshëm të fëmijës	5.00 €
7	Pëlqim për përfaqësim në gjykata për fëmijë lidhur me trashëgimi, kontratave të ndryshme etj.	5.00 €
8	Pëlqim për udhëtim jashtë vendit për familje	5.00 €
9	Pëlqim për bartjen e pasurisë	3.00 €
10	Pëlqim për dokumentet e udhëtimit	3.00 €
11	Konstatimet të ndryshme zyrtare	5.00 €

19.6 Nga bashkëpagesat për shërbimet shëndetësore të ofruara sipas paragrafit 19.3, 19.4, 19.5 të kësaj rregulloreje, lirohen të gjitha kategoritë e popullatës të parapara me nenin 61 të ligjit për shëndetësi me numër Nr .04/L-125.

19.7 Çmimet për shërbimet shëndetësore të ofruara sipas paragrafit 19.3, 19.4 për shtetasit e huaj dhe bartës të sigurimeve të huaja do të jenë për pesë (5) herë më të larta se sa për banorët e Kosovës.

Neni 20

Me prezantimin e dokumentit të dëshmisë, anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve, invalidët e luftës, veteranet, personat me aftësi të kufizuara, anëtarët e ngushtë të viktimave të luftës dhe personat që realizojnë ndihma sociale në Qendrën për Punë Sociale, këto kategori lirohen nga pagesa e të gjitha shërbimeve Shëndetësore.

Neni 21

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Pjesa 9

Taksat vjetore komunale për automjetet e regjistruara në territorin e Komunës së Hanit të Elezit

Taksa vjetore:

21.1	Automjetet me peshë deri më 3,5 ton	10.00 €
21.2	Automjetet me peshë mbi 3,5 ton	20.00 €

Neni 22

Automjetet e intervencës, automjetet e Kryqit të Kuq, automjetet speciale të mbrojtjes shëndetësore, automjet e zjarrfikëseve, të ndërmarrjeve publike (automjetet për transportimin e të vdekurve, mjetet motorike për pastrimin e kanalizimeve dhe lumenjve, automjetet për bartjen e mbeturinave, mjetet motorike për transportimin e fekaleve, mjetet motorike për bartjen e kafshëve të ngordhura etj.) dhe automjetet e shfrytëzuesve të administratës komunale, nuk i nënshtrohen pagesës së këtyre taksave.

Neni 23

Automjetet bujqësore nuk i nënshtrohen pagesës së taksave Komunale për automjet.

Neni 24

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Pjesa 10: Taksat në xehetari dhe bujqësi

24.1	Taksat për dhënien e pëlqimit për shfrytëzim të ujit për ekonomi familjare	50.00 €
24.2	Taksat për dhënien e pëlqimit për shfrytëzim të ujit për subjekte afariste	100.00 €
24.3	Kompensimi për shëndrrim të tokës bujqësore dhe pyjore në tokë ndërtimore – për m ²	
a)	klasa e 1-4 kompensimi do të jetë	1.00 €
b)	klasa e 5-6 kompensimi do të jetë	0.75 €
c)	klasa e 7-8 kompensimi do të jetë	0.50 €
24.4	Kërkesa për vlerësimin e gjendjes në teren	
a)	Për persona Fizik	20 €
b)	Për persona Juridik	50 €
24.5	Shërbimet profesionale për prerje të pyeve private	

a)	Dru zjarri për m ³	1.50€
b)	Dru zjarri mbi 7m ³	2.0€
c)	Dru teknik m ³	3.0€
24.6	Taksa për kullotje – bagëti për një vit	
a)	Gjedhe mbi një vit, për copë	1.20 €
b)	Viçat, për copë	0.54 €
c)	Delet, për copë	0.22 €
d)	Qengjat, për copë	0.12 €
e)	Kuajt dhe gomarët, për copë	1.20 €
f)	Derrat, për copë	0.36 €
g)	Dosat	0.60 €
h)	Rosat	0.02€

Neni 25

Invalidët dhe invalidët e luftës me invaliditet trupor më tepër se 50% nuk i nënshtrohen pagesës së këtyre taksave.

Neni 26

Ngarkesat vjetore sipas aktvendimeve do të paguheshin në konton bankar të Komunës, në çdo bankë komerciale sipas faturimit në afatin prej 30 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit.

Neni 27

Gjobat lidhur me mos paraqitjen e lindjes dhe vdekjes

1. Çdo preson fizik përgjegjës i cili nuk paraqet lindjen e fëmijës në territorin e Komunës në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga data e lindjes kryen kundërvajtje të lehtë dhe nga Komuna i shqiptohet gjobë në shumë prej njëzete euro (20 €).

2. Çdo person fizik përgjegjës i cili nuk e lajmëron vdekjen e personit të regjistruar me vendbanim në Komunë brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e vdekjes së personit brenda Republikës së Kosovës, apo brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh për vdekjet e ndodhura jashtë Republikës së Kosovës, kryen kundërvajtje të lehtë dhe nga Komuna i shqiptohet gjobë në shumë prej pesëdhjetë euro (50 €).

Neni 28

Gjobat lidhur me vendbanimin dhe vendqëndrimin

1. Çdo person fizik që ka vendbanim apo vendqëndrim në Komunë dhe i cili nuk i ndërmerr veprimet e parapara në këtë paragraf, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në shumë prej tetëdhjetë (80 €):

2. nuk e lajmëron ndryshimin e vendbanimit dhe vendqëndrimit brenda territorit të komunës, brenda tetë (8) ditësh nga ky ndryshim;

3. nuk e lajmëron largimin nga Republika e Kosovës, me qëllim të qëndrimit për më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë; dhe

4. nuk e lajmëron kthimin në Republikën e Kosovës, me qëllim të qëndrimit për më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë.

Neni 29

Gjobat lidhur me mos pagesën e taksës për ushtrimin e veprimtarisë afariste

1. Çdo shoqëri tregtare që vepron si biznes individual, i cili nuk e paguan taksën vjetore në emër të ushtrimit të veprimtarisë afariste brenda afatit të përcaktuar me këtë Rregullore, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në shumë prej pesëdhjete euro (50 €).
2. Çdo shoqëri tregtare që nuk vepron si biznes individual, i cili nuk e paguan taken vjetore në emërtë ushtrimit të veprimtarisë afariste të përcaktuar me këtë Rregullore, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në shumë prej pesëdhjetë euro (50 €).

Neni 30

Gjobat lidhur mos pagesën e taksës komunale mbi mjetet motorike

1. Çdo person fizik i cili nuk e paguan taksën komunale për mjetin motorik brenda afatit të përcaktuar në këtë Rregullore, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në shumë prej njëzet euro (20 €).
2. Çdo shoqëri tregtare që vepron si biznes individual, i cila nuk e paguan taksën vjetore për mjetin motorik brenda afatit të përcaktuar në këtë Rregullore, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në shumë prej katërdhjetë (40 €) euro.
3. Çdo shoqëri tregtare apo person tjetër juridik i cili nuk vepron si biznes individual, që nuk e paguan taksën vjetore për mjetin motorik brenda afatit të përcaktuar në këtë Rregullore, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në shumë prej njëqind euro (100 €).

Neni 31

Gjobat për mos pagesën e taksës komunale për ndërhyrje në infrastrukturë komunale dhe taksës komunale për rrënim të objekteve pa leje

1. Çdo person i cili nuk e paguan taksën komunale për ndërhyrje në infrastrukturë komunale dhe taksës komunale për rrënim të objekteve pa leje sipas afatit të përcaktuar në këtë Rregullore, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë si në vijim:
 - 1.1. për personin fizik - njëqind euro (100 €);
 - 1.2. për person fizik që ushtron biznes individual - dyqind euro (200 €); dhe
 - 1.3. për personin juridik - treqind euro (300 €).

Neni 32

Gjobat lidhur me mos pagesën e taksës komunale për vendosjen e panove reklamuese

1. Çdo shoqëri i cili nuk paguan taksë komunale mbi vendosjen e panove reklamuese e cila kalon shumë prej njëqind euro (100 €) sipas afateve të përcaktuar nga kjo Rregullore kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë si në vijim:
 - 1.1. Shoqëritë tregtare të regjistruara si biznes individual - pesëdhjete euro (50 €); dhe
 - 1.2. Shoqëritë tregtare tjera - njëqind euro (100 €) euro;

Neni 33

Gjobat lidhur me taksat komunale për vendosjen e objekteve në hapësirat publike

1. Çdo person i cili nuk e paguan taksen komunale për vendosjen e objekteve të ndryshme në hapësirën publike sipas dispozitave të kësaj Rregullore, e cila kalon shumën mbi njëqind euro (100€), kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobe si në vijim:
 - 1.1. Individët dhe shoqëritë tregtare të regjistruara si biznes individual – pesëdhjetë euro (50 €);
 - 1.2. Shoqëritë tregtare tjera - njëqind euro (100 €).

Neni 34

Pagesat e gjobave dhe çështjet tjera mandatore

1. Gjobat e përcaktuara me këtë Rregullore paguhen brenda pesëmbëdhjete (15) ditëve nga datat e shqiptimit të tyre, por jo me vonë se nëntëdhjete (90) ditë nga data e shqiptimit të tyre.
2. Në rast të pagimit të gjobës së shqiptuar me këtë Rregullore brenda afatit tridhjetë (30) ditësh, i dënuari lirohet nga pagimi pesëdhjetë përqind (50%) të shumës së gjobës së shqiptuar.
3. Presoni ndaj të cilit shqiptohet gjoba sipas dispozitave të kësaj Rregullore ka të drejtën e ankesës, sipas afateve dhe procedurave të parapara në legjislacionin në fuqi për procedurën e përgjithshme administrative.
4. Procedurat kundërvajtjes zhvillohen nga Komuna në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet.

Neni 35

Në rast se ndonjë dispozitë e kësaj rregullore është në kundërshtim me ndonjë dispozitë të Ligjit apo të udhëzimeve administrative të nivelit qendror që i rregullojnë këto lëmi, atëherë respektohen dispozitat e Ligjit, përkatësisht Udhëzimeve të nivelit Qendror.

Neni 36

Kjo rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës MPL-së dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës e njëjta do të zbatohet për vitin 2025, nëse nuk paraqiten propozime për ndryshime e njëjta do të vlejë edhe për vitet vijuese.

Hani i Elezit
Data: 30.12.2024



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA • OPSTINA • MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT
Nr. i Prot. 02 7626
Nr. i Faq. 60 Data 12.08.2026



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna -Municipality
Hani i Elezit



DATA:	12.08.2026
PËR :	Komitetin për Politikë e Financa dhe Kuvendin e Komunës
NGA:	Kryetari i Komunës z. Mehmet Ballazhi
LËNDA:	Shkresë Përcjellëse: Raporti gjashtëmuor i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2026

Të nderuar/a,

Me anë të kësaj shkrese ju përcjellim Raporti gjashtëmuor i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2026

Me respekt



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA • OPSTINA • MUNICIPALITY	
HANI I ELEZIT	
Nr. i Prot.	02 7626
Nr. i Faq.	60 Data: 12.08.2026



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA HANI I ELEZIT / MUNICIPALITY OF HANI I ELEZIT



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E HANIT TË ELEZIT • OPSTINA ELEZ HAN • MUNICIPALITY OF HANIT TE ELEZIT

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2026

Rr: “Nuri Bushi” Nr 2 , Kodi Postar 71510 Hani i Elezit, Kosovë

E-mail: mehmet.ballazhi@rks-gov.net

Tel: (+383) 0290 385 112

HYRJE

Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2026 paraqet një pasqyrë të aktiviteteve, angazhimeve dhe rezultateve të arritura gjatë periudhës janar–qershor 2026, në përputhje me kompetencat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe objektivat e përcaktuara në programin qeverisës të Komunës.

Gjatë kësaj periudhe, fokusi i qeverisjes komunale ka qenë i orientuar drejt ofrimit të shërbimeve cilësore për qytetarët, avancimit të projekteve zhvillimore, përmirësimit të infrastrukturës publike, mbështetjes së arsimit, shëndetësisë, bujqësisë, kulturës, rinisë dhe sportit, si dhe forcimit të transparencës, llogaridhënies dhe bashkëpunimit me institucionet qendrore, partnerët vendorë e ndërkombëtarë dhe shoqërinë civile.

Puna e administratës komunale gjatë gjashtëmujorit të parë është karakterizuar nga një koordinim i vazhdueshëm ndërmjet drejtorive komunale, me qëllim realizimin efikas të planit të punës dhe zbatimin e projekteve në interes të qytetarëve. Përmes angazhimit të përbashkët është arritur të realizohen një sërë aktivitetsesh dhe investimesh që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komunës.

Janë ndërmarrë masa për forcimin e administratës komunale përmes digjitalizimit të shërbimeve, ngritjes së kapaciteteve profesionale të stafit dhe përmirësimit të efikasitetit institucional.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar mbështetjes së sektorëve me rëndësi strategjike për komunën. Përmes programeve të subvencionimit dhe bashkëpunimit me partnerë të ndryshëm janë mbështetur fermerët dhe ndërmarrësit lokalë, ndërsa në sektorin e arsimit janë realizuar investime dhe aktivitete që synojnë përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe krijimin e kushteve më të mira për nxënësit dhe stafin arsimor. Në të njëjtën kohë, sektori i shëndetësisë ka vazhduar të ofrojë shërbime cilësore për qytetarët, ndërsa kultura, rinia dhe sporti janë promovuar përmes organizimit të aktiviteteve të shumta kulturore, artistike dhe sportive.

Gjatë kësaj periudhe, Komuna e Hanit të Elezit ka vazhduar të kultivojë bashkëpunimin me institucionet qendrore, organizatat ndërkombëtare, donatorët dhe partnerët zhvillimorë, duke siguruar mbështetje për projekte që kontribuojnë në zhvillimin lokal dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve.

Ky raport është përgatitur në funksion të transparencës dhe llogaridhënies institucionale, duke ofruar një përmbledhje të punës së realizuar nga Zyra e Kryetarit dhe të gjitha drejtoritë komunale gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026. Përmes tij synohet informimi i Kuvendit Komunal, qytetarëve dhe të gjithë akterëve të interesuar mbi rezultatet e arritura, sfidat e hasura dhe angazhimet e vazhdueshme për një qeverisje efikase, transparente dhe në shërbim të interesit publik.

KRYETARI I KOMUNËS

MEHMET BALLAZHI

Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Republikës së Kosovës me numër 03/L040, neni 58 paragrafi h) dhe neni 40 paragrafi d) dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit, neni 15 paragrafi c), Kryetari i Komunës harton Raportin e punës për vitin 2025:

GRUPI I PUNËS

- Kryetari i Komunës - Mehmet Ballazhi
- Nënkryetari i Komunës - Sevdi Dernjani
- Shefe e Kabinetit të Kryetarit – Liridona Ballazhi
- Zyra Ligjore - Bajrush Laçi
- Zyra e Njesisë së Burimeve Njerëzore – Ajete Duraj
- Zyra për të drejtat e njeriut, kundër diskriminimit, të drejtat e fëmijëve dhe baraza gjinore - Vjosa Rogaçi
- Drejtoria për Administratë të Përgjithshme - Natyra Kalisi Gashi
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa - Lindita Ballazhi
- Drejtoria Komunale për Arsim - Hisni Luri
- Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit - Nexhmedin Daci
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale –Kimete Kuka Hasallari
- Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë – Senad Kalisi
- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik – Majlinda Kaloshi
- Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – Abdurraman Bushi
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport – Arbenita Bajramaliu

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	2
GRUPI I PUNËS.....	3
MARRËVESHJET E ARRITURA.....	5
ZYRA LIGJORE.....	8
NJËSIA E BURIMEVE NJERËZORE.....	11
ZYRA PËR TË DREJTAT E NJERIUT, KUNDËR DISKRIMINIMIT, TË DREJTAT E NJERIUT DHE BARAZI GJINORE.....	13
ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM.....	14
DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME.....	15
DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA.....	18
DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT.....	22
DREJTORIA E URBANIZMIT, KADASTRIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT.....	31
DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE.....	36
DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK DHE TURIZËM.....	51
DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË.....	53
DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL.....	56
DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT.....	57

MARRËVESHJET E ARRITURA

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, Komuna e Hanit të Elezit ka vazhduar të forcojë bashkëpunimin institucional përmes nënshkrimit të marrëveshjeve dhe memorandumëve të bashkëpunimit me institucione publike, organizata vendore/ndërkombëtare, si dhe partnerë të tjerë zhvillimorë. Këto marrëveshje kanë për qëllim mbështetjen e projekteve me interes publik, avancimin e shërbimeve komunale, rritjen e kapaciteteve institucionale dhe krijimin e mundësive të reja për zhvillimin ekonomik, social, arsimor, kulturor dhe infrastrukturor të komunës. Në vijim paraqiten marrëveshjet e nënshkruara gjatë kësaj periudhe:

1. Aneks marrëveshje me Islamic Relief Worldwide - 02.Nr.57 e datës 05.01.2026:

Përmes kësaj Aneks Marrëveshjeje është vazhduar bashkëpunimi ndërmjet Komunës së Hanit të Elezit dhe Islamic Relief Worldwide për zbatimin e projektit "NJË RRUGË DREJT ZHVILLIMIT" gjatë periudhës janar–mars 2026. Marrëveshja mundëson vazhdimin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore falas për qytetarët, me fokus në kujdesin shëndetësor në shtëpi për lehonat dhe foshnjat, personat me aftësi të kufizuara, personat me sëmundje kronike dhe të moshuarit. Për realizimin e këtij projekti, Komuna ka ndarë **10,000 €**, të destinuara për mbulimin e kostove të ekipit profesional prej **11 punonjësish**, i përbërë nga koordinatori i projektit, mjekë, infermierë, teknik laborant dhe shofer.

2. Marrëveshje me Ministrinë e Ekonomisë – Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë – 02.Nr.1026 e datës 02.02.2026:

Kjo marrëveshje rregullon kalimin në pronësi dhe menaxhim të Komunës së Hanit të Elezit të aseteve të realizuara në kuadër të projektit “ZBATIMI I MASAVE TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË OBJEKTET NË PRONËSI TË KOMUNËS”, i implementuar në bazë të Marrëveshjes Ndihmëse të datës 03.07.2020 ndërmjet Komunës dhe Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE). Investimi, në vlerë prej 34,361.12 €, është realizuar në SHFMU “Ilaz Thaçi” në Han të Elezit. Me këtë marrëveshje, Komuna merr në pronësi dhe menaxhim të plotë asetet e investuara, duke marrë përgjegjësinë për mirëmbajtjen dhe funksionimin e tyre.

3. Memorandum bashkëpunimi me Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë – 02.Nr.1662 i datës 18.02.2026:

Qëllimi i këtij memorandumi është themelimi dhe mentorimin e Këshillit të Pacientëve në Komunën e Hanit të Elezit, me synim fuqizimin e rolit të pacientëve në sistemin shëndetësor lokal, promovimin e të drejtave të tyre, përmirësimin e komunikimit ndërmjet pacientëve dhe institucioneve shëndetësore, si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore përmes bashkëpunimit dhe përfaqësimit të interesave të pacientëve.

4. Memorandum bashkëpunimi me Fondacioni për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik – PREDA Plus dhe WEntrepreneur – 02.Nr.1849 i datës 23.02.2026:

Ky memorandum lidhet me projektin “E ARDHMJA E SAJ – Fuqizimi i Grave Sipërmarrëse në Kosovë”, i financuar nga Ministria Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ), i zbatuar nga organizata joqeveritare PREDA PLUS, në partneritet me WEntrepreneur dhe me mbështetjen e Arbeiter

Samariter BUND (ASB) Köln. Ky projekt ka filluar me 1 nëntor 2025 dhe do të zbatohet deri me 31 tetor 2028.

5. Memorandum Mirëkuptimi me Fakultetin e Edukimit/Instituti për Hulumtim dhe Zhvillim të Arsimit, si dhe me TOKA, 02.NR.2256 i dates 05.03.2026:

Me këtë Memorandum Mirëkuptimi palët u dakorduan për ofrimin e trajnimeve mbi metodologjinë e të nxëniet përmes përvijës për mësimdhënësit e komunës së Hanit të Elezit, si dhe mentorimin e tyre përgjatë implementimit të kësaj metodologjie në klasë, i cili është i vlefshëm nga data e nënshkrimit deri me 31 dhjetor 2026.

6. Memorandum i Mirëkuptimit me Organizata Kosovare për Talent dhe Arsim "TOKA" 2026 – 2029 – 02.Nr.3080 i datës 02.04.2026:

Përmes kësaj marrëveshje po bëhet për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet Komunës së Hanit të Elezit dhe TOKA-s, me qëllim zhvillimin e programeve që përmirësojnë cilësinë e arsimit, nxisin vullnetarizmin dhe aktivizmin qytetar të të rinjve, si dhe fuqizojnë rininë. Përmes iniciativës "Komunitat për Rini 2026 – 2029", synohet të krijohen më shumë mundësi për të rinjtë, të zhvillohen aftësitë e tyre dhe të rritet bashkëpunimi në nivel lokal kombëtar dhe ndërkombëtar.

7. Marrëveshje me NPL "Pastrimi" – 02.Nr.2748 e datës 23.03.2026:

Qëllimi i kësaj marrëveshje është ofrimi i shërbimeve primare të menaxhimit të mbeturinave në territorin e Komunës së Hanit të Elezit me kohëzgjatje për periudhën trevjeçare nga data 23.03.2026 deri me datën 23.03.2029.

8. Marrëveshje me Agjencionin e Punësimit të Republikës së Kosovës – 02.Nr.3811 e datës 27.04.2026:

Kjo Marrëveshje ka të bëjë me angazhimin e të diplomuarve në masën aktive të tregut të punës si praktikantë në Komunën e Hanit të Elezit, me synim përkrahjen dhe intervenimet e përkohshme për individët ose grupe të identifikuar me vështirësi për tu integruar në punësim në tregun e punës, ku qëllimi i marrëveshjes në fjalë mundëson që krahas legjislacionit referues, si dhe atij të aplikueshëm të përcaktohen të drejtat dhe detyrat/përgjegjësitë për palët me qëllim të realimit të masës aktive përkatëse.

9. Marrëveshje për thirrjen publike 02.Nr.2002 e datës 13.05.2026 nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për subvencionim të fermerëve me mekanizëm bujqësor: Marrëveshja ka të bëjë me formën, kushtet dhe obligimet e fermerëve me rastin e përfitimit nga mbështetja e fermerëve me mekanizëm bujqësor – Motokultivator me freza, me ç'rast fermerët përfitues pas pranimit të pajisjes bujqësore, do t'i nënshtrohen monitorimit tre vjeçar.

10. Marrëveshje bashkëpunimi me Islamic Relief Worldwide – Zyra në Kosovë (IRW), 02.Nr.4410 e datës 14.05.2026:

Kjo marrëveshje është lidhur për zbatimin e projektit në fushën e shëndetësisë me vlerë totale rreth 2700€, përmes së cilës Komuna obligohet të paguajë 70% të vlerës totale të projektit, ndërsa IRW obligohet të

paguajë 30% e mbetur, si dhe të sigurojë aparaturat sipas nevojës së komunës, ku parashikohen 150 glukometra, 100 tensionmetra, 10 pulsoksimetra dhe 2 pompa inhalatore.

11. Memorandum Bashkëpunimi me AQH (Kujdesi Shëndetësor I Qasshëm dhe Cilësor), 02.Nr.4562 I datës 18.05.2026:

Kjo marrëveshje është lidhur me qëllim të bashkëfinancimit mes Komunës dhe AQH-së për renovimin e dyshemesë së QKMF-së në Han të Elezit, ku komuna obligohet për mbulimin e 20% të vlerës apo 3,910 Euro, ndërsa AQH obligohet të mbulojë pjesën prej 80% apo rreth 15,630 Euro.

12. Memorandum Bashkëpunimi me Shoqatën e Gruas “DUA”, 02.Nr.5687 i datës 25.06.2026:

Ky Memorandum është lidhur me qëllim të bashkëpunimit në organizimin dhe realizimin e CrossRoads Fest – International Cultural Festival 2026 – “The Light Edition”, I cili u mbajt nga data 2 – 5 korrik 2026, Festival i cili synon promovimin e kulturës, artit bashkëkohor, trashëgimisë kulturore dhe potencialit turistik të Hanit të Elezit në nivel vendor dhe ndërkombëtar.

13. Marrëveshje me NPL “Pastrimi”, 02.Nr.4244 e datës 08.05.2026:

Komuna lidhë këtë marrëveshje me përfaqësuesin e kësaj kompanie me qëllim të dhënies në shfrytëzim të kamionetës e blera nga projekti i financuar nga Bashkimi European ne kuader të projektit "A Smart System for Early Floods Detection and Waste Monitoring in the Lepenec River Basin" me Nr 2023/450-723, programin për bashkëpunim ndërkufitar IPA II - CBC Kosove - Maqedonia e Veriut si pjese e pastrimit monitorimit të lumit Lepenc. me këto karakteristika të certifikatës së regjistrimit CRA 2389129, regjistrimin me numër 05-913-IN, pronë e Komunes Hani i Elezit.

ZYRA LIGJORE

Zyra ligjore është e radhitur në organogramin e komunës në zyrën e Kryetarit të Komunës, e cila gjatë gjashtëmujorit të vitit 2026 ka vazhduar punët dhe detyrat në bazë të përshkrimit të detyrave të punës dhe udhëzimeve të tjera nga ana e eprorit, përkatësisht nga Kryetari i komunës dhe gjithashtu bashkëpunimin me Drejtorët e drejtorive dhe me zyrtarë të tjerë. Si zyre kemi bashkëpunuar me të gjithë sektorët e komunës dhe kemi arritur që pajtueshmëria e akteve të komunës të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi. Shkurtimeisht do të paraqesim numrin e akteve juridike të përpiluara gjatë gjysëmvitit të parë të 2026. Në këtë zyrë gjatë periudhës së raportimit, janë përpiluar akte juridike të cilat do t'i shënojmë në tabelën e mëposhtme dhe do t'i krahasojmë me gjysëmvitit të kaluar:

Viti	Vendime	Përgjigje ne kërkesa	Përgjigje ne padi	Autorizime	Njoftime	Vërtetime	Rekomandime	Kërkesat në inst. qendrore	Kontratë mbi shërbimin	Përgjigje ne kërkesë auditorve
2025	100	6	80	5	4		2	4	0	1
2026	113	5	70	2	0	-	1	6	0	0
Dif.										

Duke pasur parasysh pozitën dhe detyrat e zyrës ligjore të gjitha aktet juridike të lartshënuara kanë qenë të hartuara dhe të mbështetura në dispozitat e aplikueshme të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.

Kuvendi i komunës së Hanit të Elezit gjatë gjysmës së parë të vitit 2025 ka miratuar vendime, akte juridike brenda fushës së kompetencës së tij të cilat do t'i paraqesim sipas muajve vijues dhe do të bëjmë krahasimet me gjysmë vitin 2025, duke i specifikuar vendimet dhe rregulloret.

Muaji	Janar		Shkurt		Mars		Prill		Maj		Qershor		Korrik		Gusht		Shtator		Tetor		Nentor		Dhjetor	
Viti	2026	2025	2026	2025	2026	2025	2026	2025	2026	2025	2026	2025	2026	2025	2026	2025	2026	2025	2026	2025	2026	2025	2026	2025
Vendime	7	1	3	4	2	5	2	3	4	3	5	5												
Rregullore										1														

Nga kjo tabelë rezulton se gjatë gjashtëmujorit të vitit 2025, në gjashtëmujorin e parë, nga Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit janë miratuar gjithsej 21 vendime, ndërsa në gjashtëmujorin e vitit 2026, të gjashtëmujorit të parë 2026, janë miratuar 23.

Sa i përket vendimeve të miratuara, Zyra Ligjore prej muajit janar të vitit 2026 deri në muajin që po raportojmë, në afatin e paraparë ligjor, ka përcjellë të gjitha aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit me shkresë përcjellëse në MAPL (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal), për shqyrtim të ligjshmërisë, të parapara sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Vendimet janë cilësuar me efekt të plotë juridik dhe nuk kanë qenë në kundërshtim me legjislacionin. (Këtu duhet të ceket se MAPL nuk ka përcjellë konfirmimet për të gjitha aktet tona të miratuara, por vetëm për disa që kanë qenë në kompetencë të tyre.)

Zyra Ligjore, përveç çështjeve juridike të sipërpërmendura, merret edhe me përfaqësime juridike në gjykata.

Gjatë periudhës së raportimit, në Komunën e Hanit të Elezit ka pasur padi të ndryshme, por më shumë kemi padi për shujta, kualifikime, inflacione dhe transport, pasi që kemi ardhur në përfundim se Gjykata Supreme e Kosovës ka dhënë një mendim juridik se këto kërkesa të mësimdhënësve janë me bazë ligjore dhe se lejohen deri me shfuqizimin e kontratës kolektive më 22.11.2022. Kemi diskutuar me Kryetarin e Komunës, Sindikatën e Arsimit dhe me avokatët e mësimdhënësve dhe kemi arritur pajtime gjyqësore për shkak të ekonomizimit të procedurës dhe shpenzimeve të panevojshme, duke arritur pajtime me periodha të ndryshme sipas kërkesëpadive të ushtruara.

Sa i përket shpenzimeve të transportit, kemi arritur pajtimin që ata mësimdhënës që udhëtojnë të heqin dorë nga këto shpenzime dhe shumica e tyre kanë hequr dorë. Ata që kanë vazhduar, gjykata ua ka refuzuar kërkesëpaditë në mungesë të provave të udhëtimit me autobus urban brenda territorit.

E gjatë vitit 2025 dhe 2026 kemi pranuar padi të reja nga ana e mësimdhënësve, kryesisht për kompensimin e orëve gjatë pandemisë COVID-19, pagesën e orëve për mbi normë e padi për kujdestari, e po ashtu kemi pranuar edhe padi për kualifikim, inflacion dhe shujta ditore, edhe pse me kontratë kolektive të shfuqizuar, prapëseprapë janë ushtruar padi të tilla, e që po e rrit ndjeshëm punën si zyrë, sepse të gjitha paditë bëhen individualisht.

Si zyrë ju kemi bërë përgjigje në padi dhe kemi përfaqësuar Komunën në gjykata edhe për padi të tjera të ndryshme, si në Gjykatën Themelore në Ferizaj, Dega në Kaçanik, edhe në atë Komerciale dhe në Gjykatën Administrative, e kemi pasur raste edhe në Gjykatën Supreme.

Gjithashtu, pas marrjes së aktgjykimeve në shkallën e parë të gjykatës, kemi bërë ankesa në gjykatën e shkallës së dytë. Gjatë kësaj periudhe kemi mbajtur rreth 45 seanca gjyqësore në Gjykatën Themelore në Ferizaj, Dega në Kaçanik, dhe në Prishtinë.

Për të gjitha llojet e padive, duke respektuar Ligjin për Procedurën Kontestimore, kemi bërë prapësime procedurale me përgjigje në padi në afatin ligjor, përfaqësimin e tyre me autorizim nga ana e Kryetarit të Komunës, sipas ftesave të Gjykatës.

Vlen të theksohet se për shkak të moszbatimeve të pajtimeve gjyqësore, mospagesave direkte nga Ministria e Financave, nga mospagesa e drejtpërdrejtë pagesat e tilla disa prej tyre janë kryer me propozim për përmbiminin përmes përmbaruesit privat, e shumica e tyre pa përmbarues.

Zyra Ligjore ka vazhduar bashkëpunimin me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe me ministritë e tjera në fushën e ligjshmërisë të akteve ligjore dhe nënligjore.

Kjo zyrë ka bërë pajtueshmërinë e akteve ligjore në Komunë nëpër sektorë dhe kemi dhënë disa komentime lidhur me dispozitat e Ligjeve, Rregulloreve apo Udhëzimeve Administrative.

Kemi pasur tri punëtori me Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe me OSBE-në, ku unë jam edhe kryesues i Kolegjiut të Zyrave Ligjore. Janë trajtuar projektligje, udhëzime administrative dhe rregullore të ndryshme të cilat prekin nivelin lokal, e më së tepërmi është diskutuar kontrata kolektive e arsimit, ku shumë komuna janë të dëmtuara financiarisht me marrjen e mjeteve nga kategori të ndryshme të buxhetit, e për këtë arsye edhe shumë komuna janë dëmtuar në performancën e tyre në aspektin e zbatimit të projekteve kapitale, por edhe në aspekte të tjera financiare.

Për këtë arsye, Komuna jonë dhe shumë komuna të tjera kanë ushtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër Ministrisë së Arsimit dhe Shëndetësisë, për shkak se këto ministri nuk kanë ndarë ndonjë fond me të cilin komunat nuk do të dëmtoheshin, pasi pjesë nënshkruese e marrëveshjes kolektive nuk janë komunat.

Po ashtu kemi paditur edhe MAPL-në në Gjykatën Themelore në Prishtinë për shkak të grantit të performancës, mosharmonizimit të dokumentacioneve, e sa i përket shkallës së parë, Gjykata ka nxjerrë vendim dhe e ka miratuar në tërësi masën e përkohshme të Komunës sonë, duke konstatuar pretendimet e Komunës sonë për shkak të shpenzimeve kapitale deri në 76.75% dhe moszbatimin e një akti të ligjshmërisë në rishqyrtim.

Po ashtu, nga ana e gjykatave, po në këtë gjashtëmuor, për shkak të padive tona në dy raste të pronave të Komunës së Hanit të Elezit, pasi që kishim paditur MMPHI-në, kemi marrë edhe vendimet nga Gjykata e Apelit, ku me një rast Komuna jonë është shpërblyer me 293,049.44 € (dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e dyzet e nëntë euro e dyzet e katër cent), ndërsa në rastin tjetër 614,542.27 € (gjashtëqind e katërmbydhjetë mijë e pesëqind e dyzet e dy euro e njëzet e shtatë cent), gjithsej 907,591.71 €.

BAJRUSH LAÇI
Shef i Zyrës Ligjore

NJËSIA E BURIMEVE NJERËZORE

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore edhe gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 ka vazhduar me përkushtim maksimal në sigurimin e zbatimit të procedurave ligjore lidhur me menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në Komunën e Hanit të Elezit.

Të gjitha aktivitetet janë zhvilluar konform dispozitave të përcaktuara, bazuar në Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrat e Publikë, Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës, si dhe rregulloret përcjellëse për zbatimin e këtyre ligjeve.

Në Njësinë e Burimeve Njerëzore, gjatë periudhës janar – qershor 2026, janë kryer disa aktivitete, duke filluar nga mirëmbajtja dhe menaxhimi i dosjeve personale të zyrtarëve, mbarëvajtja e procedurave të rekrutimit të nëpunësve civilë, nëpunësve të shërbimit publik dhe nëpunësve administrativë dhe mbështetës. Janë përgatitur konkurset, akt-emërimet, kontratat për marrëdhënien e punës, duke proceduar më tutje listat e pagave dhe ndryshimet në paga për nëpunësit, kërkesat dhe shkresat përcjellëse, bashkëpunimi me mbikëqyrësit gjatë vlerësimit të rezultateve në punë për vitin paraprak, bashkëpunimi me Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, njoftimin e punëtorëve rreth pushimeve dhe festave zyrtare, zbatimin e Ligjit për Zyrat e Publikë, miratimi i lëndëve në intranet, etj.

Janë përgatitur: 8 vendime për mëditje jashtë vendit, 7 vërtetime mbi marrëdhënien e punës, 6 vërtetime për masë disiplinore në dosje, 2 vendime mbi caktimin e detyrave shtesë, 2 vendime për përfundimin e marrëdhënies së punës (dorëheqje), plani i trajnimeve për vitin 2026, 10 shkresa përcjellëse, 4 vendime për përvojën e punës, etj.

Njësia e Burimeve Njerëzore ka zhvilluar procedurat e rekrutimit, duke përfshirë shpalljen e pozitave, verifikimin paraprak, vendimet për formimin e komisioneve të përzgjedhjes, organizimin e testeve dhe intervistave, shpalljen e rezultateve përfundimtare, etj. Gjatë periudhës janar – qershor të vitit 2026 janë shpallur procedura të rekrutimit, të cilat janë:

Pranimi në shërbimin civil

Nr.	Pozita	Njësia	Numri i procedurës	Realizimi
1.	Zyrtar i Lartë për GIS - projekt	Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit	RPC0012834 RN00019295	Realizuar
2.	Zyrtar i lartë për planifikim hapësor - projekt	Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit	RPC0012833 RN00019294	Realizuar pjesërisht
3.	Zyrtar për Shërbim me qytetarë	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme	RPC0013061 RN00019522	Dështuar
4.	Zyrtar për mbështetje ligjore	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	RPC0013113 RN00019574	Dështuar

5.	Zyrtar i larte per planifikim hapesinor - projekt	Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit	RPC0013252 RN00019713	Realizuar
6.	Zyrtar për Bujqësi	Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	RPC0013299 RN00019760	Në proces

Pranimi në shërbimin publik

Nr.	Pozita	Njësia	Numri i Procedurës	Realizimi
1.	Edukator/e kopshti i fëmijëve 3-6 vjeç	IP"Arthemëria"	RPC0012740 RN00019201	Realizuar
2.	Psikolog/e	SHFMU "Ilaz Thaçi"	RPC0012819 RN00019280	Realizuar
3.	Asistent/e për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta	SHFMU "Ilaz Thaçi"	RPC0012962 RN00019423	Realizuar
4.	Mjek i Përgjithshëm	QKMF"Dr.Menduh Kaloshi"	RPC0013011 RN00019472	Realizuar
5.	Infermier/e H17/6.4	QKMF"Dr.Menduh Kaloshi"	RPC0013012 RN00019473	Realizuar
6.	Infermier/e H20/6.1	QKMF"Dr.Menduh Kaloshi"	RPC0013013 RN00019474	Realizuar
7.	Drejtor i QKMF-së	QKMF"Dr.Menduh Kaloshi"	RPC0013290 RN00019751	Anuluar
8.	Mësimdhënës i lëndës matematikë	SHFMU"Veli Ballazhi" SHFMU"Kështjella e Diturisë SHML"Dardania"	RPC0013472 RN00019933	Në proces
9.	Mësimdhënës/e për arsim fillor	SHFMU "Ilaz Thaçi"	RPC0013473 RN00019934	Në proces

AJETE DURAJ

Menaxhere e Njesisë së Burimeve Njerëzore

ZYRA PËR TË DREJTAT E NJERIUT, KUNDËR DISKRIMINIMIT, TË DREJTAT E NJERIUT DHE BARAZI GJINORE

Më datë 23.02.2026, Komuna e Hanit të Elezit, në kuadër të Planit Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore (PLVBGJ), me përkrahje nga projekti **Gender Equality Facility**, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga **UN Women**, ka organizuar punëtorinë me temën **“Format e ndryshme të dhunës me bazë gjinore dhe mbrojtja nga dhuna kibernetike”**. Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë gjithsej 32 pjesëmarrës, prej të cilëve 21 femra dhe 11 meshkuj. Qëllimi i punëtorisë ka qenë informimi dhe ndërgjegjësimi i pjesëmarrësve lidhur me format e ndryshme të dhunës me bazë gjinore, si dhe me rreziqet dhe mënyrat e mbrojtjes nga dhuna kibernetike.

Gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar edhe **mbledhjet e rregullta të KKS-së**, në të cilat përfaqësuesja për barazi gjinore ka marrë pjesë dhe ka kontribuar në trajtimin e çështjeve që lidhen me barazinë gjinore dhe përfshirjen e perspektivës gjinore në aktivitetet dhe proceset komunale.



Gjithashtu, Komuna e Hanit të Elezit ka shënuar **8 Marsin – Ditën Ndërkombëtare të Gruas**, me qëllim të promovimit të barazisë gjinore, respektimit të të drejtave të grave dhe vajzave dhe ndërgjegjësimin për rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë në jetën shoqërore dhe institucionale.

Në fushën e arsimit, **Drejtoria e Arsimit** ka realizuar ndarjen e subvencioneve për studentë, përmes të cilave janë ndarë gjithsej **51 bursa**. Nga ky numër, **37 bursa janë përfutur nga vajzat dhe 14 nga djemtë**, duke kontribuar në mbështetjen e studentëve dhe vazhdimin e shkollimit të tyre.

Me rastin e **Ditës së Fëmijëve – 1 Qershorit**, janë organizuar aktivitete edukativo-arsimore, si dhe aktivitete argëtuese për fëmijët. Këto aktivitete janë realizuar në bashkëpunim ndërmjet Komunës së Hanit të Elezit dhe kompanisë **Sharcem**, duke krijuar mundësi për fëmijët që këtë ditë ta shënojnë përmes aktiviteteve të ndryshme edukative dhe argëtuese.

Po ashtu, Komuna vazhdon të ofrojë **mbështetje financiare për fëmijët e porsalindur, vajza dhe djem**, me qëllim të mbështetjes së familjeve dhe përmirësimit të mirëqenies së fëmijëve. Deri në periudhën për të cilën raportohet, mbështetja financiare për fëmijët e porsalindur është **për 83 fëmijë**.

Këto aktivitete pasqyrojnë angazhimin e Komunës së Hanit të Elezit në promovimin e barazisë gjinore, mbështetjen e fëmijëve dhe familjeve, si dhe në krijimin e mundësive të barabarta për vajzat dhe djemtë në fushën e arsimit dhe në jetën shoqërore.

VJOSA ROGAÇI Zyrtare për të drejtat e njeriut, kundër diskriminimit, të drejtave të fëmijëve dhe baraza gjinore

ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Gjatë periudhës raportuese, Komuna e Hanit të Elezit ka ndërmarrë disa aktivitete në drejtim të hartimit të **Draft Planit Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Hanit të Elezit për periudhën 2026–2028.**

Në kuadër të këtij procesi, Komuna ka **themeluar Grupin Punues** për hartimin e Draft Planit, me përfaqësues nga njësitë dhe sektorët përkatës të Komunës. Grupi Punues është angazhuar në koordinimin e aktiviteteve, mbledhjen e informatave dhe identifikimin e nevojave të personave të riatdhesuar dhe të huajve në territorin e Komunës.

Gjatë kësaj periudhe janë **realizuar takime të Grupit Punues**, në të cilat janë diskutuar çështje të ndryshme që lidhen me procesin e riintegrimit të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve. Në këto takime janë shqyrtuar nevojat, sfidat dhe mundësitë për ofrimin e mbështetjes institucionale në nivel lokal.

Komuna ka zhvilluar **bashkëpunim ndërmjet drejtorive dhe njësive përkatëse komunale**, me qëllim të koordinimit të aktiviteteve dhe sigurimit të informatave të nevojshme për hartimin e Draft Planit. Në këtë proces janë përfshirë fushat që kanë të bëjnë me arsimin, shëndetësinë, mirëqenien sociale, punësimin, shërbimet administrative dhe përfshirjen në komunitet.

Gjithashtu, Komuna ka bashkëpunuar me **institucionet përkatëse të nivelit qendror dhe akterë të tjerë relevantë**, duke shkëmbyer informacione dhe duke koordinuar aktivitetet që lidhen me riintegrimin dhe integrimin. Ky bashkëpunim ka kontribuar në identifikimin e nevojave dhe në përcaktimin e masave dhe aktiviteteve që do të përfshihen në Draft Plan.

Në kuadër të punës së Grupit Punues janë **mbledhur dhe shqyrtuar të dhëna dhe informacione relevante** lidhur me situatën dhe nevojat e personave të riatdhesuar dhe të huajve në Komunën e Hanit të Elezit. Të dhënat dhe informacionet e mbledhura janë përdorur gjatë hartimit të objektivave dhe aktiviteteve të Draft Planit për periudhën 2026–2028.

Po ashtu, është punuar në **përgatitjen dhe hartimin e Draft Planit Komunal**, duke përcaktuar objektivat, aktivitetet, përgjegjësitë e institucioneve dhe masat që synojnë mbështetjen e personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunitetin lokal.

Gjatë procesit të hartimit është kushtuar rëndësi edhe **koordinimit dhe konsultimit ndërmjet anëtarëve të Grupit Punues**, me qëllim që Draft Plani të përfshijë nevojat dhe prioritetet e identifikuara në nivel lokal dhe të jetë në përputhje me kompetencat dhe mundësitë e Komunës së Hanit të Elezit.

ARSIM DERNJANI

Zyrtar për komunitete dhe kthim

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Aktivitetet:

- Trajnim me Women4CyberKosova për ndërgjegjësimin në përdorimin e sigurt të teknologjisë.
- Vazhdimi i funksionalizimit të linjës telefonike pa pagesë.
- Pjesëmarrja në Forumin e Tretë për Qeverisjen e Hapur Lokale dhe Inovacionet Demokratike.
- Vazhdimi i implementimit të rrjetit publik WiFi në bashkëpunim me EU4WB.
- Koordinimi i inspektimit nga Arkivi i Kosovës.
- Regjistrimi i 5,830 lëndëve administrative.
- Ofrimi i 4,568 shërbimeve në fushën e gjendjes civile.
- Dorëzimi i shprehjes së interesit në kuadër të projektit "Forcimi i Qeverisjes Shumënivelëshe dhe Demokracisë Pjesëmarrëse" të Këshillit të Evropës.
- Pranimi i listës së mallrave të konfiskuara në bashkëpunim me Komisionin për Mallrat e Konfiskuara.

PUNËT E KRYERA SIPAS SEKTORËVE:

SHËRBIMET NË QENDRËN E SHËRBIMIT ME QYTETARË

	Përshkrimi	Numri i lëndëve 2026	Numri i lëndëve 2025
1	Kuvendi Komunal	65	57
2	Kryetari i Komunës	425	562
3	Drejtorja e Administratës së Përgjithshme	3,766	2,600
4	Drejtorja për Buxhet dhe Financa	141	119
5	Drejtorja për Arsim	169	143
6	Drejtorja e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit	987	835
7	Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	18	10
8	Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	67	90
9	Zyra e Prokurimit	23	36
10	Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës	48	60
11	Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	78	51
12	Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport	43	49
TOTALI:		5,830	4,612

SHËRBIMET NË GJENDJEN CIVILE

Nr	Dokumenti	Total
1	Certifikata e statusit martesor	81
2	Certifikata e vdekjes	144
3	Certifikata e lindjes	540
4	Certifikata e vendbanimit	589
5	Deklarate e bashkekesise familjare	522
6	Certifikata e shtetësisë	14
7	Certifika e martesës	544
8	Vërtetimi nga arkiva	18
9	Ekstrakti i lindjes	2,162
Totali		4,614

SHËRBIMET NË KUVENDIN KOMUNAL

	Përshkrimi	Mbledhje të rregullta	Solemne / Të jashtëzakonshme	Mbledhje inaguruese
1	Kuvendi Komunal.	6	1	1
2	Komiteti për Politikë dhe Financa.	6	/	/
3	Komiteti për Komunitete.	6	/	/

SHËRBIMET NË AUTOMJETET ZYRTARE KOMUNALE

	Viti 2025	Viti 2026
Kërkesa për shfrytëzim të automjeteve zyrtare	249 kërkesa	183 kërkesa
Kilometra të kaluara	63505 km	49993 km
Karburante të shpenzuara	5563 L	4384 L

	Automjeti dhe targat	Litra të hargjuara	Kilometra të kaluara	Shpenzime për 100 km
1	Kia sportage 05-177-GF	885 l/naftë	10170 km	8.7 L/100 km
2	Hyundai ix35 05-408-GQ	644 l/naftë	6394 km	10.7 L/100 km
3	Hyundai i20 05Z-04-33	421 l/naftë	6590 km	6.3 L/100 km
4	Toyota Prado 05Z-05-33	613 l/naftë	5587 km	10.9 L/100 km
5	Dacia Duster 05Z-10-33	605 l/benzinë	7268 km	8.3 L/100 km
6	Dacia Duster 05Z-11-33	658 l/benzinë	7766 km	9.4 L/100 km
7	Dacia Duster 05Z-12-33	380 l/benzinë	4294 km	8.8 L/100 km
8	Golf 5 Plus 05Z-20-33	110 l/naftë	1310 km	8.3 L/100 km

10	Gjeneratori i komunës	20 l/naftë	/	/
	Derivate me autorizim kositja e parkut te Komunes	20 l/benzinë	/	/

SHËRBIMET NË DEPO KOMUNALE

	Përshkrimi	Numri i artikujve	Vlera
1	Raporti i pranimit të mallrave	35 artikuj të ndryshëm	2337.41€
2	Raporti i ngarkimit të mallrave	105 artikuj të ndryshëm	10,663.59€

SHËRBIMET NË ARKIVËN KOMUNALE

Bazuar në Raportin Statistikor të lëndëve të arkivuara për gjashtëmuorin e parë 2026, të cilat përmbushin kriteret për Arkivin Elektronik në SMAED, në përputhje me Ligjin për Arkiva.

Numri i lëndëve të arkivuara	Numri i lëndëve të asgjësuar	Numri i dokumenteve
Të dhënat do të konfirmohen nga MDAP	Të dhënat do të konfirmohen nga MDAP	Të dhënat do të konfirmohen nga MDAP

Në fushën e transparencës, Komuna e Hanit të Elezit, respektivisht Kryetari i Komunës së bashku me ekzekutivin e poashtu sekretaria e kuvendit kanë përgaditur dhe përcjellur materiale për publikim të informacioneve, aktiviteteve, dokumente, vendime, marrëveshje mirëkuptimi dhe dokumente relevante për informim sa më të mirë për qytetarët.

Në fushën e IT-së janë bërë këto instalime dhe konfigurime si vijim:

- Instalime në pakon Microsoft office tek njësitë kërkuese.
- Instalime të printerëve, skanerëve dhe pajisjeve të tjera përcjellëse.
- Formatimi i disa kompjuterëve brenda objektit të komunës,
- Bashkëpunim me ASHI- MDAP,
- Asistim me pajisje dhe shërbime në IT në administratën e QKMF-së, shkolla, çerdhe, Qendra per Dokumenta- MPB Hani i Elezit etj.

Aktiviteti	Numri
Formatizime & Instalime PC/Laptop	52
Instalime printerësh/skanerësh	50
Ndihmë teknike / IT Support	80
TOTAL	182

NATYRA KALISI GASHI

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Drejtoria për Buxhet dhe Financa për vitin 2026, funksionin e vet e ka ushtruar në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore mbi qeverisjen e Komunave të Republikës së Kosovës, Statutin e komunës së Hanit të Elezit, Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Ligjin mbi financat e pushtetit lokal, Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, Ligjin mbi tatimin në pronën e paluajtshme, Rregulloret dhe udhëzimet administrative nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

Drejtoria për Buxhet dhe Financa me qëllim të realizimit sa më efikas të të gjitha kompetencave dhe përgjegjësi, ka funksionuar kryesisht në katër (4) sektorë:

1. Sektori për buxhet
2. Sektori për financa,
3. Sektori për të hyra dhe
4. Sektori i tatimit në pronë.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa e menaxhuar nga drejtoresha e drejtorisë dhe me një staf prej (8) zyrtarëve, gjatë vitit 2026 kishte një angazhim permanent, me një përkushtim të madh në drejtim të realizimit sa më të suksesshëm të të gjitha objektivave dhe detyrave të parashikuara në planin e punës së drejtorisë. Aktiviteti i drejtorisë ka qenë i përqëndruar në realizimin e buxhetit sipas dinamikës së planifikuar dhe menaxhimin sa më efikas të buxhetit.

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit me NR. 10/L-001 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2026 është në lartësi prej **4,234,682.00 Euro.**

Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim:

- Paga dhe shtesa..... 2,505,202.00 €,
- Mallra dhe shërbime..... 571,000.00 €,
- Shpenzimet komunale111,000.00 €,
- Subvencione dhe transfere... 185,000.00 €,
- Shpenzime kapitale..... .. 862,480.00 €,
- Totali i buxhetit..... 4,234,682.00 €.

Ndërsa buxheti përfundimtar është **4,957,985.57 €** ku në këtë shumë përfshihen:

1. Mjetet e ndara nga Grantet Qeveritare në shumë prej **3,877,962.00 €**,
2. Projekcioni i Të Hyrave Vetanake në shumë prej **356,720.00 €**,

3. Donacioni nga Unioni Evropian për projektin dy vjeçar “A smart system for Early Floods Detection and Waste Monitoring in the Lepenc River Basin” në shumë prej **141,903.98 €**,
4. Bartja e bilancit të pashpenzuar nga viti 2025 në vitin 2026 në shumë prej **580,184.23 €**,
5. Donacion nga Këshilli i Evropës në shumë prej **1,101.68 €**,
6. Mjete të mbetura nga Grante të cilat janë bartur vit pas viti në vlerë prej **113.68 €**.

Punët dhe aktivitetet të cilat janë zhvilluar gjatë periudhës janar-qershor 2026, mund t'i veçojmë këto:

SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA

- Përgatitja e raporteve mujore të të hyrave dhe shpenzimeve mujore janar-qershor 2026 publikimi në ueb faqen e Komunës,
- Përgatitja e raporteve mujore të punës dhe aktiviteteve të Drejtorisë Buxhet dhe Financa dhe dorëzimi i tyre në Kabinetin e Kryetarit si dhe publikimi në ueb faqen e Komunës në formatin PDF dhe Word,
- Deklarimi në Thesar obligimet e pa paguara dhe ato kontraktuale janar-qershor 2026,
- Barazimi me Thesar periudha janar-qershor 2026,
- Plotësimi i projeksionit të të hyrave vetanake 2027-2029 dhe dorëzimi i projeksionit në Departamentin e Buxhetit – MFPT,
- Përgatitja dhe publikimi i borxhit publik për çdo muaj në web faqe të Komunës,
- Pranimi i Qarkoreve Buxhetore 2027/01 nga Departamenti i Buxhetit – MFPT,
- Mbajtja e takimeve me grupin punues për hartimin e KAB-it 2027-2029,
- Përgatitja e kërkesës për bartjen e bilancit të pashpenzuar nga viti 2025 në vitin 2026 dhe dorëzimi për shqyrtim dhe miratim nga Kuvendi Komunal,
- Pas miratimit në Kuvend Komunal, kërkesa për bartjen e bilancit të pashpenzuar nga viti 2025 në vitin 2026 është dorëzuar në Departamentin e Buxhetit – MFPT, nga ku edhe është miratuar dhe e njejta është përditësuar në SIMFK,
- Hartimi i orarit të dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029,
- Publikimi i njoftimit për orarin e dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029,
- Hartimi i Planit të Dëgjimeve Buxhetore për KAB 2027-2029 dhe publikimi në web faqen e Komunës në dy formate: word dhe pdf,
- Hartimi i një përgjigje me shkrim për një Asambleist të cilat i ka kërkuar gjatë mbledhjes së Kuvendit Komunal,
- Publikimi i Raportit Financiar Janar-Mars në web faqen komunale në tri formate: Word, PDF dhe Excel,

- Plotësimi i një pyetësoi nga Divizioni i Auditimit të Brendshëm – MFPT,
- Hartimi i KAB-it 2027-2029 dhe dorëzimi në KPF dhe Kuvend Komunal,
- Mbajtja e 3 dëgjimeve buxhetore për KAB 2027-2029 nën organizimin e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Mbajtja e një dëgjimi buxhetor për KAB 2027-2029 nën organizimin e Kryesuesit të Kuvendit Komunal dhe Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Miratimi i KAB-it 2027-2029 në Kuvend Komunal,
- Publikimi i procesverbaleve dhe listës së pjesëmarrësve në web faqen e Komunës,
- Pranimi i Raportit të Auditimit të PVF 2025 nga Zyra Kombëtare e Auditimit,
- Dorëzimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029 në Departamentin e Buxhetit – MFPT,
- Hartimi i Raportit Financiar Janar-Qershor 2026,
- Hartimi i Raportit të Dëgjimeve Buxhetore për KAB 2027-2029,
- Publikimi i Raportit të Dëgjimeve Buxhetore për KAB 2027-2029,
- Dorëzimi i Raportit të Monitorimit të Investimeve Kapitale sipas Periudhave (Q1) në Departamentin e Buxhetit – MFPT,
- Përgatitja e kërkesës për rialokimin e mjeteve në kuadër të kategorisë buxhetore Investime Kapitale në shumë prej 129,880.00 €,
- Përgatitja e një kërkesë për aprovim nga Departamentin e Buxhetit – MFPT lidhur me futjen e një projekti të ri kapital në kuadër të Buxhetit të vitit fiskal 2026,
- Pranimi i Raportit të auditimit të vitit 2025 nga NJAB-MFPT,
- Llogaritja dhe realizimi i të gjitha pagesave të destinuar për pagesën e pagave dhe shtesave të Administratës Komunale, të këshilltarëve Komunal, komiteteve të ndryshme të Kuvendit, të Sektorit të Arsimit dhe Sektorit të Kujdesit Primar Shëndetësor.

RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT PËR PERIUDHËN JANAR - QERSHOR 2026

Kategoritë ekonomike të shpenzimeve	Buxheti 2026	Realizimi janar-qershor 2026	% Realizim
Paga dhe shtesa	2,505,202.00	1,437,427.18	57.3
Mallra dhe shërbime	683,925.12	162,137.12	23.7
Shpenzime komunale	138,023.33	46,366.20	33.5
Subvencione dhe trans.	240,089.00	91,075.60	37.9
Shpenzime kapitale	1,390,746.12	101,531.12	7.3
TOTAL	4,957,985.57	1,838,537.22	37.08

SEKTORI PËR TË HYRAT

Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2026 është në shumë prej 356,720.00 €. Në kuadër të këtij sektori janë kryer këto aktivitete:

- Përpunimi, harmonizimi dhe barazimi i evidencave të detajizuara të të gjitha llojet e të hyrave sipas programeve buxhetore, fondeve dhe kodeve ekonomike në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK),
- Pranimi i të hyrave indirekte për TM1 2026 nga Gjobat e Policisë në shumë prej 25,270.00 € dhe nga Agjensioni Pyjor i Kosovës në shumë prej 392.48 €,
- Alokimi i të hyrave të inkasuara në Nën – Programe dhe kategori buxhetore varësisht prej planifikimeve buxhetore,
- Bartja e bilancit të pashpenzuar nga viti 2025 në vitin 2026 në shumë prej 580,184.23 €.
- Inkasimi i të hyrave vetanake për periudhën raportuese janar-qershor 2026 është në shumë prej 101,455.62 € apo 28.4% nga projeksioni i të hyrave.

Të hyrat indirekte gjatë periudhës raportuese janë në shumë prej 56,680.00 € nga Gjobat në trafik dhe 392.48 € nga Agjensioni Pyjor i Kosovës. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak këto të hyra janë më të larta për 10,413.73 €.

SQARIM SHITESË: Të hyrat e periudhës raportuese janar-qershor 2026 nuk janë plotësisht të sakta, si pasojë e mungesës së zyrtarit për regjistrim të të hyrave vetanake. Rrjedhimisht, të hyrat vetanake nuk janë regjistruar nga muaji prill deri në muajin qershor. Kur të pajisemi me qasje për regjistrimin e të hyrave në SIMFK, të njëjtat do të regjistrohen manualisht dhe do të reflektohen në raportet vijuese.

SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

Gjatë kësaj periudhe, ky sektor ka pasur këto aktivitete:

- Lëshimin e faturave të tatimit në pronë,
- Lëshimin e vërtetimeve për qëllime të ndryshme,
- Përgatitja e një Njoftimi për afatin e pagesesës së kështit të parë të faturave të tatimit në pronë si dhe masat aplikuese në rast të mos pagesës,
- Publikimi i njoftimit në web faqen komunale dhe në faqen zyrtare në Facebook,
- Përgatitja e kërkesës për vlerësimin e një prone të paluajtshme në Divizionin e DVPPTP – Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve,
- Vizitë zyrtare e Inspektorave të Departamentit të Tatimit në Pronë.

LINDITA BALLAZHI

Drejtorja për Buxhet dhe Financa

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

Emërtimi i aktiviteteve	KOHA E REALIZIMIT												Implemen tues	Janar – Qershor 2026
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII		Realizimi
Hartimi i dinamikës dhe përcjellja e fillimit të vitit të ri shkollor. Vizitë me kryetarin e Komunës në shkollë me qëllim të urimit të nxënësve dhe arsimtareve	√					√			√				DKA, Kuvendi Komunal	Është realizuar vizita në fillim të vitit shkollor.
Vazhdimi i bashkëpunimit me lidhjet e krijuara me Drejtori Komunal dhe shkollë të shteteve të ndryshme si dhe krijimi i lidhjeve të reja me interes për shkollat dhe arsimin e Hani të Elezit	√	√	√	√	√								DKA & Shkollë	Kemi bashkëpunuar me komunën e Kaçanikut, shkëmbimi i mesimdhënësve, marrveshje regjionale për arsimin për të rritur.
Bashkëpunimi me MASHT-in-, Zyrën Rajonale të Inspeksionit në fushën e arsimit.	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	DKA	Me inspektoriatin vazhdimisht kemi bashkëpunuar
Analiza e suksesit të nxënësve gjatë dy periudhave gjysmëvjetorin e parë dhe në fundin e vitit shkollor (Raport në Kuvend)							√			√			DKA	Janë paraqitur përfundimi i gjysmëvjetorëve në kuvend komunal.
Organizimi i garave në nivel komune me nxënës të shkollave fillore, të mesme të ulët dhe të mesme të larta në dritare, recitim, muzikë, art, shkenca, etj.			√	√	√								DKA & Shkollë	Jane realizuar vetëm garat të përgjithshme në dituri.
Java e gjelbërimit për shkollat e komunës				√									DKA, Komuna & Shkollë	Është shënuar Dita e Tokës në të gjitha shkollat
Organizimi dhe bartja e nxënësve për garat në lëndë të ndryshme				√	√								DKA & Shkollë	Organizuar dhe realizuar garat e diturisë me nxënës të 3-12 me nxënës të të gjitha shkollave.
Përgatitja dhe regjistrimi i nxënësve të klasave parafillor dhe fillor					√								DKA & Shkollë	Regjistrimi është kryer në kohë në të gjitha shkollat
Vizitat mjekësore në bashkëpunim me QKMF, Hani të Elezit					√							√	DKA- QKMF	Jane realizuar vizitat nga QKMF në

														HFMU-të per epideminë
Organizimi i garave shkollore në sport si ne: futboll të vogël , basketboll ,volejbolll dhe atletike.					√	√							DKA	Garat ne korrik dhe qershor I kemi realizuar, ne futboll, volejbolll dhe sportet tjera.
Raporti 6 mujor i Drejtorisë për Arsım,						√							DKA	Raportohet për raportin 6 mujor në KPF dhe Kuvend Komunal
Kompletimi dhe dërgim i të dhënave në MASHT me qëllim publikimi të konkursit për regjistrim te nxënësve në SHML (Shkollat e Mesme te Larta)						√							DKA- MASHT	Është përgadit konkurs për regjistrimin e nx.në shkollë të lartë
Përcjellja e procedurës se regjistrimit të nxënësve në shkollat e mesme të larta						√	√	√	√				DKA	Regjistrimi i nx.në klasë të 10 është kryer
Përgatitja e vendimeve për shkuarje në pushim vjetor të punëtorëve arsimore							√						DKA	
Shpallja e konkursit të rregullt për plotësimin e vendeve të lira të punës me mësimdhënës të kualifikuar							√						DKA	Shpallja e konkurseve është kryer në afatet e qershorit.
Formimi i komisionit për përgatitjen e testit vlerësues dhe respektimit të procedurave për përzgjedhjen e personelit arsimor							√						DKA	SMBNJ dhe DKA sipas kërkesave nga shkollat..
Shpallja e konkursit plotësues për regjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme								√					DKA- MASHT	Eshte realizuar,
Organizimi dhe mbajtja e intervistës me kandidatët konkurrues								√					DKA	Jane relizuarar sipas komisionit
Vlerësimi dhe përzgjedhja e personelit arsimor në bazë të konkursit të rregullt sipas UA								√					DKA	Korrik dhe vazhdimisht sipas nevojave per zevendesimet.
Përcjellja e procedurës së regjistrimit të nxënësve në shkollat e mesme nga konkursi plotësues								√					DKA	E realizuar

Përcjellja e punës së shkollave për realizimin e ekskursioneve të maturanteve									√				DKA	E realizuar 20 maj SHML, dhe qershor per SHFMU
Informatë mbi fillimin e vitit shkollor									√				DKA	
Plani i punës për vitin 2027 i Drejtorisë për Arsim,												√	DKA	I realizuar ne dhjetor 2025

Emërtimi i aktiviteteve	KOHA E REALIZIMIT												Implementues	Realizimi
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII		
Mirëmbajtja (rregullimi) i shkollave dhe oborreve shkollore				√	√	√	√	√	√				DKA & Shkolla	I vazhdueshem
Riparimi i nyejve të ujës/jellësve dhe përmirësimi i furnizimit të shkollave të cilat kanë probleme me ujë të pijshëm							√	√	√				Shkollat & DSHPE	I realizuar
Përzgjedhja e operatorit për furnizimin e shkollave me lëndën djegëse në koordinim me Zyren e Prokurimit.								√					DKA	Ne proces
Ndërtimi i SHFMU në Lagje të Re	I përhershëm												MASHT, DKA	Ne proces
Ndërtimi i Institucionit parashkollor në lagje të re.	I përhershëm												MASHT, DKA	Ne proces
Furnizimi i shkollave me material për administratën e shkollave	Sipas kërkesave												DKA & Shkolla	
Furnizimi i shkollave me materiale për zhvillimin e aktiviteteve të lira sipas prioriteteve të shkollave	Sipas kërkesave												DKA & Shkolla	
Implementimi i pjesës që ka të bëjë me Planin Zhvillimor të DKA-s	Në vazhdimësi												DKA, K.Komunal	

Raporti i punës që kanë të bëjnë me procesin edukativo-arsimor gjatë vitit 2026

Emërtimi i aktiviteteve	KOHA E REALIZIMIT												Implementues	Realizimi
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII		
Monitorimi i sistemit SMIA nga DKA-ja	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	DKA	
Organizimi i trajnimeve për mësimdhënës në Qendrën për Ngritje Profesionale sipas Prioriteteve të Planit për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve të Komunës së Hanit të Elezit	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	DKA, MASHT, dhe OJQ tjera me programe të akredituara	-Marrëveshje me ojq SHPIK-un për trajnimin e mësimdhënësve në lëndën e kodimit dhe përgaditjen për sfidën Bebras, Si DKA, organizuam dhe realizuam trajnimin, për korrikulën Bërthamë për gjithë mësimdhënësit që nuk e kishin këtë trajnim tejet të rëndësishëm dhe shumë të nevojshëm
Përgatitjet për kremtimin e festave shtetërore		√				√					√		DKA	I realizuar
Sigurimi i një ambienti të shëndetshëm për shkollën dhe rregullimi i këndeve të gjelbëria shkollore				√	√	√			√				DKA	
Përcjellja e braktisjes së nxënësve-detyrë permanente				√	√	√			√	√	√	√	DKA	
Bashkëpunimi me OJQ në fushën e realizimit të drejtave të fëmije dhe sigurisë së nxënësve në shkolla-detyrë e përhershme, kundër trafikimit, punës së fëmijëve në rrugë, drogës, etj				√	√	√			√	√	√	√	DKA	E realizuar me ojq dhe SHPK
Vlerësimi i punës edukativo arsimore të shkollave nëpërmjet vizitave dhe bashkëpunimit me prindër				√	√	√			√	√	√	√	DKA & Shkolla	
Analiza e punës edukativo-arsimore							√			√			DKA	
Shpallja e konkurseve për plotësimin e	Sipas nevojës												DKA	I realizuar

vendeve te lira të punës sipas kërkesave të shkollave			
Plotësimi i vendeve të lira te punës	Sipas nevojës	DKA	
Përcjellja permanente e aktiviteteve mësimore e jashtëmësimore të nxënësve nëpër shkolla	E vazhdueshme	DKA & Shkolla	
Rregullimi i dokumenteve për pronat e shkollave sipas sipërfaqes kadastrale	E vazhdueshme	DKA	E realizua per SHFMU ne Lagje te Re
Përcjellja e lëvizjes se personelit arsimor	I përhershëm, sipas nevojës	DKA	
Mbarimi i mësimit për maurantet	Sipas kalendarit të hartuar nga MASH-ti	MASHT, DKA	Përfundimi i viti shkollor për maurantet.
Provimi i maturës	Sipas kalendarit të hartuar nga MASH-ti	MASHT, DKA	Eshtë mbajtur testi i maturës
Publikimi i rezultateve të provimit të maturës	Sipas kalendarit të hartuar nga MASH-ti	MASHT, DKA	Shpallja e rezulateve është krye.
Shqyrtimi i ankesave të nxënësve	Sipas kalendarit të hartuar nga MASH-ti	MASHT, DKA	Ankesat e nx.janë adresuar në Masht sipas procedurës
Publikimi i rezultateve të ankesave	Sipas kalendarit të hartuar nga MASH-ti	MASHT, DKA	Jan njoftuar ankuesit përmes sistemit të E-Kosovës
Testi i arritshmërisë për klasat e IX-ta	Sipas kalendarit të hartuar nga MASH-ti	MASHT, DKA	Eshte mbajtur testi i arritshmërisë
Paraqitja e provimit për afatin e gushtit	Sipas kalendarit të hartuar nga MASH-ti	DKA	eKosova
Provimi i maturës - afati i dyte	Sipas kalendarit të hartuar nga MASH-ti	MASHT, DKA	eKosova
Publikimi i rezultateve të provimit të maturës, afati i dytë	Sipas kalendarit të hartuar nga MASH-ti	MASHT, DKA	eKosova
Shqyrtimi i ankesave të nxënësve	Sipas kalendarit të hartuar nga MASH-ti	MASHT, DKA	eKosova
Publikimi i rezultateve të ankesave	Sipas kalendarit të hartuar nga MASH-ti	MASHT, DKA	eKosova

Aktiviteti dhe bashkëpunimi i DKA-s me Kryetarin e Komunës, MASHT-in, drejtorët e drejtorive nga komunat tjera dhe me qytetarët.

Emërtimi i aktiviteteve	KOHA E REALIZIMIT												Implementues	Realizimi
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII		
Takimet e rregullta me drejtorët e shkollave fillore,	√	√	√	√	√	√			√	√	√	√	DKA	I realizuar

të mesme dhe institucionit parashkollor														
Pranimi i raporteve mujore të punës nga drejtorët e shkollave dhe shqyrtimi i tyre	√	√	√	√	√	√			√	√	√	√	DKA	I realizuar
Pjesëmarrja e rregullt në mbledhjet e Kolegjiumit të Drejtoreve të DKA-ve të Kosovës				√	√	√	√		√	√	√	√	DKA	I realizuar
Furnizimi me ligjet, udhëzimet, vendimet dhe rregulloret që dalin nga MASHT-i	Sipas nevojës												DKA, MASHT	I realizuar
Përcjellja e kërkesave, raporteve dhe informatave nga aktiviteti i DKA-se në MASHT	Sipas nevojës												DKA, MASHT	I realizuar
Bashkëpunimi i rregullt me Zyrën e Inspeksionit të arsimit në nivel regjional	Sipas nevojës												DKA	I realizuar
Takimet dhe konsultimet me Kryetarin e Kuvendit Komunal	I përhershme, sipas nevojës												DKA	I realizuar
Bashkëpunimi i rregullt me drejtorët e drejtorive komunale, në veçanti me DKRS	I përhershëm, sipas nevojës												DKA	I realizuar
Bashkëpunimi me Shoqatën Handakos	Sipas mundësive dhe nevojës												DKA	
Puna me palët, shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave	E përditshme dhe sipas nevojës												DKA	I realizuar
Takimet e rregullta me MASHT-it në kuadër të takimeve me drejtorët e DKA-ve	Te përhershme, varësisht nga ftesat												DKA, MASHT	I realizuar

Bashkëpunimi i DKA-s me organet e sigurisë: Policinë, FSK-n KFOR-in, OJQ-të dhe media

Emërtimi i aktiviteteve	KOHA E REALIZIMIT												Implementues	Realizimi
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII		
Pjesëmarrja në debatet me teme arsimore e shoqërore organizuar nga OJQ-të	Sipas organizimit dhe ftesës												DKA	I realizuar, ojQ Toka. Teach for Kosovo. Shpik.
Bashkëpunimi me shërbimin Policor të Kosovës	Sipas nevojës												DKA	I realizuar sipas nevojave dhe planit të trajnimeve.
Bashkëpunimi me FSK-në	Sipas nevojës												DKA	Permes KKSBB

Kontaktet me përfaqësues të KFOR-it dhe të organizatave ndërkombëtare	Sipas kërkesave	DKA	I realizuar permes Kforit polak dhe Italian LMT
Bashkëpunimi me organizata të ndryshme vendore e të huaja	Sipas kërkesave	DKA	Me organizatën TOKA në fushën e edukimit dhe rinisë nënshkruam Marrëveshje Bashkëpunimi për katër vitet e ardhshme, kjo marrveshje synon realizimin e projekteve konkrete për edukimin dhe fuqizimin e të rinjëve në komunën tonë. -Nënshkruam marrveshje bashkëpunimi për trajnimin e mësimitdhënësve nga Fakulteti i Edukimit me ojq TOKA. -Marrëveshje me ojq SHPIK-un për trajnimin e mësimitdhënësve në lëndën e kodimit dhe përgaditjen për sfidën Bebras.
Bashkëpunimi me donatore vendore e të huaj	Sipas nevojës	DKA	Marrveshje me RTM per Qerdhen trajnimet, Pranuam donacionin të tavolinave dhe bankave me ulëse për shkollat nga qendra e trajnimeve Creative Hub Kosovo.

Bashkëpunimi me përfaqësuesit e Kuvendit Komunal për implementimin e projekteve që kanë të bëjnë me integrimet evropiane

Emërtimi i aktiviteteve	KOHA E REALIZIMIT	Implementues	
-------------------------	-------------------	--------------	--

	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII		Realizimi
Përmirësimi i infrastrukturës, transportit dhe sigurisë në shkolla	Ne vazhdimësi												DKA	Finalizimi i instalimeve tabelave Smart faza e dytë ku kompletohen të gjitha klasat në të gjitha shkollat. Zhvilluam trajnim për sigurinë në punë për punëtorët teknik të institucioneve tona, nga Kompania BS Sulation.
Hartimi i programeve, plan programeve dhe përgatitja e moduleve të trajnimit të mësimdhënësve me theks të veçantë integrimi i gjinisë femërore si temë specifike	Ne vazhdimësi												DKA	Është nënshkruar memorandum i cili do të shërbejë për formalizimin e bashkëpunimit ndërmjet organizatës “Volontari nël Mondo RTM” dhe komunës sonë për implementimin e projektit PEDAKOS II. Si DKA, organizuam dhe realizuam trajnimin, për korrikulën Bërthamë për gjithë mësimdhënësit që nuk e kishin këtë trajnim tejet të rëndësishëm dhe shumë të nevojshëm.
Identifikimi i shkollave që kanë nevojë për ndërtim dhe renovim, si dhe hartimi i listës me prioritet	Ne vazhdimësi												DKA	Ndërtim i Ri, Lagje e Re, SHFMU DHE IP,
Përmirësimi i hapësirave ekzistuese shkollore (renovimi) dhe mbikëqyrja e punëve gjatë renovimeve	Ne vazhdimësi												DKA	Në shfmu”Ilaz Thaçi” janë mbulu shkallët e brendshme të shkollës me vynil, duke siguruar një shtresë mbrojtëse dhe më shumë elegancë, si dhe duke eliminuar vrazhdësinë e terraserit.

Identifikimi i nevojave për materiale dhe pajisje, si dhe përcaktimi i prioriteleve të shkollave me nevoja me te theksuara	Sipas kërkesave	DKA & Shkolla	SHFMU Ilaz Thaçi (dhoma e vlersimit per femijet me nevoja te veqanta, lyerja e paraleles Seçishtë, Kendi i lojrave IP, rregullimi I kulmit SHML dhe SHFMU Ilaz Thaçi, panelet solare.
--	-----------------	---------------	---

Të arriturat më të rëndësishme nga raporti gjashtëmujor i Drejtorisë së Arsimit për vitin 2026:

- Është nënshkruar memorandum, i cili do të shërbejë për formalizimin e bashkëpunimit ndërmjet organizatës “Volontari nel Mondo RTM” dhe Komunës për implementimin e projektit PEDAKOS II.
- Është bërë finalizimi i instalimit të tabelave Smart, faza e dytë, ku janë kompletuar të gjitha klasat në të gjitha shkollat.
- Zhvilluam trajnimin për sigurinë në punë për punëtorët teknikë të institucioneve tona, nga kompania BS Solution.
- Organizuam dhe realizuam garat e diturisë me nxënësit e klasave 3–12, me pjesëmarrjen e nxënësve nga të gjitha shkollat.
- Pranuam donacionin e tavolinave dhe bankave me ulëse për shkollat nga Qendra e Trajnimeve Creative Hub Kosovo.
- Si DKA, organizuam dhe realizuam trajnimin për Kurrikulën Bërthamë për të gjithë mësimdhënësit që nuk e kishin ndjekur këtë trajnim, i cili është tejet i rëndësishëm dhe shumë i nevojshëm.
- Me organizatën TOKA, në fushën e edukimit dhe rinisë, nënshkruam Marrëveshje Bashkëpunimi për katër vitet e ardhshme. Kjo marrëveshje synon realizimin e projekteve konkrete për edukimin dhe fuqizimin e të rinjve në Komunën tonë.
- Nënshkruam Marrëveshje Bashkëpunimi për trajnimin e mësimdhënësve me Fakultetin e Edukimit dhe OJQ-në TOKA.
- Nënshkruam marrëveshje me OJQ-në SHPIK për trajnimin e mësimdhënësve në lëndën e kodimit dhe përgatitjen për sfidën Bebras.
- Kemi shpallur thirrjen publike për bursat studentore për vitin akademik 2025/2026, ku 51 studentë kanë përfituar.
- Në SHFMU “Ilaz Thaçi” janë mbuluar shkallët e brendshme të shkollës me vinil, duke siguruar një shtresë mbrojtëse dhe më shumë elegancë, si dhe duke eliminuar vrazhdësinë e terraserit.

HISNI LURI
Drejtoria Komunale e Arsimit

DREJTORIA E URBANIZMIT, KADASTRIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

URBANIZMI

I AKTIVITETET

1. Në pajtim me kërkesat e ligjit për planifikim hapësinor nr.04/L-174, Drejtoria e Urbanizmit ka vazhduar me procedurat e hartimit respektivisht përfundimit të hartimit të HARTËS ZONALE të KOMUNËS. Për këtë qëllim, komuna ka angazhuar për një periudhë gjashtëmujore tre ekspert të jashtëm. Pritjet janë që deri në fund të vitit të përfundoj ky proces.
2. Po ashtu, në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Trashigimisë Natyrore, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor kemi përfunduar procedurat e identifikimit dhe miratimit në kuvendin e komunës të katër vlerave të trashigimisë natyrore (monumente natyrore) si mëposhtë vijon: (1) Parku dhe Ujëvara në qytetin e Hanit të Elezit, (2) Kanioni në fshatin Dremjak, (3) Trungu i Bungëbutes në fshatin Dremjak dhe (4) Kepi i gjatë dhe burimi i ujit në lagjen Laq- Pustenik.
3. Në bashkëpunim me Axhencionin Kosovar të Privatizimit (AKP)- Drejtoria e Urbanizmit ka iniciuar procedurat për fitimin e pronësisë mbi 11 parcele kadastrale (kryesisht rrugë) të cilat janë prona shoqërore të ish kombinatit “Sharr” të mbetura jashtë privatizimit, e të cilat menaxhohen nga AKP.
4. Kemi hartuar paramasat dhe paralogaritë për të gjitha projektet kapitale të planifikuara për realizim vitin 2026. Në mungesë të mjeteve të mjaftueshme buxhetore, nga lista e projekteve nuk do të mund të realizohen këto projekte:
 - “Ndërtimi i rrugës Seqishtë kah Vorbat” buxheti i ndarë për këtë projekt është 30,000€ ndërsa paramasa dhe paralogaria është në shumë prej 98.000€,
 - “Rregullimi i rrugës Fujza-Vertomicë” buxheti është 15,480€ ndërsa projekti është në shumë prej 405,000€ dhe:
 - “Rregullimi i prockave dhe kanalizimeve atmosferike në f. Paldenicë, Rezhancë dhe Seqishtë” buxheti është në shumë prej 15,000€ ndërsa paramana është në shumë prej 220,000€.

Më poshtë, po japim listën e projekteve kapitale të cilat pritet të realizohen vitin 2026 si dhe statusin e tyre momental:

II PROJEKTET INVESTIVE KAPITALE

Lista e projekteve investive kapitale për vitin 2026 në kuadër të DUKMM

EMRI i PROJEKTIT	FINANCUESI I PROJEKTIT	BUXHETI	PUNË-KRYESI	STATUSI MOMENTAL I PROJEKTIT	KOHËZGJATJA
Asfaltimi i rrugës Goranc-Krivenik	MI Komuna	1,114,0000	Rahovica Compani	Kan filluar punimet e fazës së fundit	2024 2025 2026
Shtrim me kubëza betoni i rrg. që	Komuna	46,693	-	Para tenderimit	2026

lidhë f. Rezhancë me varrezat					
A smart system ...Lepenci River Basin	IPA fonde MMPH	400,000	-	Projekti është në përfundim	2025 2026
Shtrim me kubëza betoni të rrugicave në zonat urbane dhe rurale Hani Elezit	Komuna	98,427		Para tenderimit	2026
Ndërtimi i trotoareve për këmbësor në Hani të Elezit në rrg. Adem Jashari, Udha e Shkronjave, Driton Loku Paldenicë	Komuna	48,078	-	Para tenderimit	2026
Asfaltimi i rrg. Ekzodi 99 H.E	Komuna	11,000 Faza II		E përfunduar	2025 2026
Rregullimi i varrezave të qytetit dhe fshatrat: Gorancë, Pustenik dhe Rezhancë	Komuna	48,000		para përfundimit	2025 2026
Rregullimi i rrugës prej te burimi deri në Lepenc	Komuna	40,000		E përfunduar	2025 2026
Rregullimi i kanalizimeve neper zonat urbane dhe rurale te Hani te Elezit	Komuna	8,500	-	E tenderuar	2026
Ndërtimi (rihapja dhe zgjerimi) i rrugëve në zonat rurale	Komuna	65,000	-	Para tenderimit	2026
Fabrika e ujit nga ujësjells i Dimcës, shtëpia e kulturës-Imri Curri, oborri i komunës, stadiumi i qytetit-SuadBrava shpronësim	Komuna	60,000	MMPH	Nga Qeveria është miratuar vendimi përfundimtar për shpronësim	2026 2027
Ndërtimi i mureve mb.	Komuna	76,290		Para tenderimit	2026

Ndërtimi i rrg, nënbreg f. Seqishtë	Komuna	20,000	-	Para tenderimit	2026
Shtrim me zhavorr i rrg. prej burimit të f. Seqishtë deri te Lloka	Komuna	32,000	-	Para tenderimit	2026
Mjete të lira për bashkë investime	komuna	10,000	-	-	2026

Shënim: Në listën e projekteve kapitale janë paraqitur vetëm projektet me kod 66480 Planifikimi Urban dhe Inspeksioni dhe jo projektet e tjera të cilat janë në drejtoritë tjera.

III LEJET NDËRTIMORE

Gjatë kësaj periudhe, Sektori i Urbanizmit, ka lëshuar 3 leje ndërtimore dhe pesë çertifikata të legalizimit. Pesë kërkesa tjera për legalizim për arsye të mos kompletimit të dokumentacionit kanë hyrë në listë të pritjes. Janë realizuar të hyra në shumë prej 9,280.79€ në emër të taksës komunale për leje ndërtimi dhe leje legalizimi.

Të hyrat nga lejet ndërtimore dhe legalizimi gjashtëmujorin e parë 2026

Emërtimi	VITI 2025	VITI 2026	%
Nr. i lejeve ndërtimore	-	3	-
Të hyrat (taksa nga lej. ndërtimore)	0.00€	8,387.79€	%
Nr. i legalizimeve	7	5	-28.5%
Të hyrat nga legalizimi	635.36€	893.12€	+40.5%

IV MBROJTJA E MJEDISIT

Në fushën e mbrojtjes së mjedisit janë kryer inspektime të rregullta nga inspektorja e mjedisit lidhur me ndalimin e hedhjes së mbeturinave jashtë pikave grumbulluese, pengimin e hedhjes së mbeturinave inerte në natyrë: lum dhe procka, kontrollimin e vazhdueshëm të operatorëve ekonomik, gurëthyesve si dhe ndotësve tjerë të ambientit dhe aty ku është parë e arsyeshme janë bërë vërejtje me gojë.

Me kërkesë të zyrtarëve të MMPHI-së, (Departamenti për Mbrojtjen e Natyrës), jemi angazhuar në aktivitetet lidhur me identifikimin e vlerave të trashëgimisë natyrore në komunën tonë.

Sektori i Mjedisit duke u bazuar në Planin Lokal për Veprim në Mjedis – listën e aktiviteteve, ka shënuar Ditën Ndërkombtare të Tokës së bashku me kompanin Sharrcem me një sërë aktivitete vetëdijësuese me nxënësit e shkollës fillore, ligjërata, mbjellje drunjesh, lule etj. që japin mesazhe për mbrojtjen dhe ruajtjen e ambientit.

Po ashtu, në gjashtëmujorin e parë kemi lëshuar një pëlqim mjedisor komunal dhe kemi realizur të hyra në shumë prej 388.66€ në emër të taksës për pëlqim mjedisor.

Të hyrat e sektorit të Mjedisit për gjashtë mujorin e parë të vitit 2026

Emërtimi	2025	2026	%
Të hyrat nga Lejet Mjedisore Komunale	0.00€	388.66€	-
Gjobat Mandatore	0.00€	0.00€	-
Gjithsej	0.00€	388.66€	-

V KADASTRI

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026, është rritur numri i aplikimeve (kërkesave) për shërbime kadastrale nga 757 sa ishin në gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar në 937 sivjet ose 180 lëndë më shumë. Më poshtë po japim tabelën e lëndëve të realizuara gjashtëmujorin e parë të vitit 2026:

Raporti i lëndëve të kryera në gjashtëmujorin e parë 2026 viti

Emërtimi i kërkesës	Numri i kërkesave	Pagesa
Qertifikata prone	445	558.00 €
Kopje plani	218	308.00 €
Bartje pronësie	79	2,430.00 €
Ndarje fizike të parceleve	17	470.00 €
Blerje të pikave	64	509.00 €
Bashkim të parceleve	6	60.00 €
Vërtetim që nuk posedon pronë	61	3.00 €
Modifikim pronësie	17	0.00 €
Regjistrim hipoteke	4	120.00 €
Ç'regjistrim hipoteke	0	0.00 €
Historiat të parceleve	1	0.00 €
Regjistrim objekti (njësi banesore)	5	0.00 €
Korigjim të sipërfaqeve	4	0.00 €
Përgjigje në kërkesa për info. Kadastrale	0	0.00 €
Kërkesë për barrë tatimore	1	0,00€
Kontrata për shfrytëzim të pronës Komunale	1	0.00€
Kërkesë për modifikim të attributeve të parceleve	0	0.00 €
Të tjera të ndryshme	11	0.00 €
Kërkesë për modifikim-rirregullim të kufijve	2	40.00 €
Taksa për shfrytëzim të pronës publike	1	887.67€
GJITHËSEJT:	937	5.385.67€

Në periudhën Janar-Qershor 2026 viti, Kadastri ka realizuar të hyra në shumë prej 5,385.67€ apo për 8.8% më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

TË HYRAT E DREJTORISË PËR GJASHTËMUJORIN E PARË 2026

Të hyrat e Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, në gjashtëmuja të parë të vitit 2026 janë në shumë prej 15,055.24€ apo 169% më shumë se periudha e njëjtë e vitit të kaluar.

Të hyrat e drejtorisë për periudhën Janar-Qershor 2026

SEKTORI	Të hyrat 2025 viti	Të hyrat 2026 viti	%
U r b a n i z m i	635.36€	9,280.24€	+1361%
K a d a s t r i	4,950€	5,385,67€	+8.8%
M j e d i s i	0.00 €	388.66€	-
Gjithësejt:	5,585.36 €	15,055.24€	+169%

NEXHMEDIN DACI

Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Gjatë periudhës gjashtëmujore, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka realizuar një varg aktivitete të rëndësishme në fushën e shëndetësisë publike, promovimit të shëndetit, fuqizimit të pjesëmarrjes së qytetarëve në sistemin shëndetësor, si dhe në mbështetjen e familjeve në nevojë përmes bashkëpunimit me organizata vendore dhe ndërkombëtare.

Aktivitetet shëndetësore:

Gjatë periudhës janar–qershor 2026, në QKMF janë ofruar gjithsej 29,592 shërbime shëndetësore. Numrin më të madh të shërbimeve e përbëjnë kontrollat mjekësore (12,146) dhe intervenimet (12,159), të cilat përbëjnë pjesën dërmuese të aktivitetit të institucionit.

Përveç tyre, janë realizuar 2,414 analiza laboratorike, 281 ekzaminime RTG, 498 shërbime stomatologjike, 455 shërbime në AMF Gorancë, 537 vaksinime, 486 shërbime këshillimore dhe 616 vizita shtëpiake, duke dëshmuar angazhimin e vazhdueshëm të stafit në ofrimin e shërbimeve shëndetësore primare për qytetarët.

Bashkëpunimi institucional

Është zhvilluar takim me organizatën Islamic Relief, ku pas përfundimit të marrëveshjes së bashkëpunimit të deritanishëm u vlerësuan rezultatet e arritura. Me këtë rast u ndanë mirënjohje për të gjithë punonjësit që kanë qenë të angazhuar në realizimin e aktiviteteve të përbashkëta.

Themelimi i Këshillit të Pacientëve-Në kuadër të rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në sistemin shëndetësor: është themeluar zyrtarisht Këshilli i Pacientëve.

Aktivitetet për promovimin e shëndetit

Në kuadër të kësaj jave janë realizuar aktivitete të shumta:

- stafi i QKMF-së ka mbajtur ligjërata edukative me pacientët kronikë;
- pacientëve u janë siguruar aparate për matjen e tensionit arterial dhe aparate për matjen e glikemisë, me qëllim lehtësimin e kujdesit të vazhdueshëm për shëndetin e tyre;
- në bashkëpunim me Qendrën Rajonale të Shëndetit Publik janë organizuar matje falas të tensionit arterial për qytetarë dhe janë shpërndarë broshura informuese dhe edukative për parandalimin dhe kontrollin e hipertensionit.

Aktivitetet e dhurimit të gjakut dhe shërbimeve preventive

Në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës, më 12 qershor, në kuadër të Javës së Dhurimit të Gjakut është organizuar aksioni vullnetar i dhurimit të gjakut, ku kanë marrë pjesë 107 dhurues vullnetarë.

Gjithashtu është realizuar Karvani Shëndetësor "PërSHËNDETje", ku qytetarëve u është ofruar matje falas e tensionit arterial; matje falas e glikemisë; këshillim profesional nga personeli shëndetësor për mënyrën e jetesës dhe kujdesin ndaj shëndetit.

Mbështetje me pako ushqimore dhe me veshmbathje

- Janë shpërndarë 440 pako: 65 pako ushqimore të dhuruara nga ALBA GROUP ;75 pako ushqimore të tjera të dhuruara nga ALBA GROUP; 200 pako ushqimore të siguruara nga King Salman Humanitarian Aid and Relief Centre, në bashkëpunim me Bashkësinë Islame të Hanit të Elezit dhe Shoqatën Humanitare "Bereqeti"; 50 pako ushqimore për familjet në nevojë, të dhuruara nga Ambasada e Emirateve të Bashkuara Arabe në Podgoricë dhe 50 pako me mish, të dhuruara nga Humanity First.
- Veshmbathje 75 familje: 32 nga Dogana e Kosovës dhe 43 të dhuruara nga ALBA GROUP.
- 1640 dhurata për fëmijët për dy festat e Bajramit nga ALBA GROUP

Informatë mbi gjendjen në shëndetësi për periudhën Janar – Qershor 2026

Aktivitetet e planifikuara :

- Ngritja e cilesise së shërbimeve shendetesore dhe realizimi I standardeve të cilësisë nga pakoja e standarteve e minimale ne KPSH .
- Furnizimi i rregullte me barna dhe material mjekesor nga lista esenciale e Ministrise se Shëndetësisë .
- Raportimi i rregulltë në IKSH- rajonale për semundjet ngjitëse dhe tumoreve (kancerit) dhe semundjeve kronike në IKSH- në Prishtinë.
- Transportimi i rregulltë i pacientëve në Hemodializë në Ferizaj (e Hënë , e Mërkurë dhe e Premte. (Ky orar mund të ndryshoj sipas nr. të pacientëve)
- Mbajtja e rregullte e edukimit te vazhdueshem profesional per infermier , trajnimi i personelit ne mjekesine familjare dhe ligjerata te rregullta ne procesin e ZHVP-se.
- Percellja e punes dhe funksionimit 2 herë në javë ne ambulancen e fshatit Gurane.
- Sigurimi i shërbimeve shendetesore 24 oreshe ne QKMF- Hani Elezit.
- Mbajtja e takimeve te Keshillit Drejtues dhe atij Profesional.
- Mbajtja dhe ruajtja e pastertise dhe ambientit te kendshem per pune.
- Mirembajtja dhe ruajtja e automjeteve te QKMF-se dhe sigurimi i karburantit per automjete dhe gjenerator.
- Ruajtja e sekretit profesional dhe konfidences ne raportet e pacientëve.
- Ruajtja dhe sigurimi i dokumentacionit mjekesor nga personat e pa autorizuar.
- Bashkepunimi me DSHMS-ne dhe subjektet tjera komunale.
- Bashkepunimi me Qendrat tjera te mjekesise familjare te komunave te Kosoves.
- Bashkepunimi me KFORIN—dhe organizatat e tjera te huaja.
- Bashkepunimi me Organizatat vendore jo qeveritare dhe qeveritare.
- Planifikimi i vaksinimit dhe imunizimit te mbi 95% te femijeve , perfshirja e vaksines HPV ne kalendar te rregullt .
- Zvogelimi i morbiditetit dhe mortalitetit te nenave shtatezane dhe femijeve te posalindur.

- Zvoglimi i komplikimeve te semundjeve kronike dhe menaxhimi adekuat i tyre.
- Parandalimi i semundjeve ngjitesh dhe semundjeve te tjera.
- Parandalimi i semundjeve kancerogjene sipas planit strategjik per mbrojtje nga keto semundje.
- Planifikojmë rritjen e numrit të vizitave shtëpiake të nanave dhe fëmijve 0-3 vjet.
- Planifikojmë rritjen e shërbimeve permes programit Grup Care 1000 prej 0- 3 vjeç.
- Planifikimi i kontrollave sistematike te nxenesit e shkollave fillore ne Komunen Hani te Elezit ne muajin Janar– Qershor 2026.
- Planifikimi i aktiviteteve (marreveshje bashkepunimi me QKMF Kaqanik per realizmin e mamografise si dhe shërbimet ultrasonografike nga Radiolog .
- Planifikojmë trajnimin e punetoreve te QKMF-se me trajnime mbi shendetin dhe sigurine ne pune.
- Planifikojmë 1 Karvane Shëndësore "PërShëndetje" – edukim dhe promovim shëndetësore ne komunitet (qershor 2026)

Gjatë periudhës Janar - Qershor 2026 ne QKMF ka pasur këto aktivitete :

- Kërkesa të vazhdueshme në MSH për rritje të stafit në sektorin e Shëndetësisë.
- Shënimin e ditëve botërore në Shëndetësi dhe aktivitete edukativo - shëndetësore sipas kalendarit te shëndetësisë është shënuar edhe në komunitetin tonë .
 - Dita e Infermierisë
 - Dita e Zemrës
 - Dita kunder Duhanit
 - Dita e Tokës
 - Transfuzioni i gjakut ne bashkepunim me DSHMS.
 - Kontrollat sistematike në shkollat fillore e mesme e ulët ne komunën tonë.
 - Ligjerata per Tuberkuloz e organizuar ne bashkëpunim me QKMF dhe IRSHP me nxënësit e Shkollës se Mesme Dardania .
 - Aktivitet edukativo – shëndetësor për javën ndërkombëtare të Hipertensionit .
 - Karvani shëndetësor “ PërShëndetje” ne muajin Qershor .

RESURSET HUMANE

QKMF-ja gjatë kësaj periudhë ka punuar me një staf prej 31 punëtorëve:

Nr.	Shërbimi /Sektori	Vendi i punës	Staf
2	QKMF	Drejtor	1
		Mjek	6
		Stomatolog	1
		Kryeinfermiere	1
		Infermier	18

	Laborant	1
	Teknik i radiologjisë	1
	Farmaciste	1
	Puntorë teknik	3

Punëtorët të QKMF-së të cilët kanë qenë të kontraktuar nga Komuna dhe Islamic Relief Kosova deri më 31 /03/2026 .

Nr.	Shërbimi /Sektori	Vendi i punës	Staf
2	QKMF	Mjek të përgjithshëm	3
		Infermier	5
		Tek.laborant	1
		Shofer	1

DONACIONET

Kompania BL Safety Solutions

Si shumë herave tjera kishim nderin të jemi përfitues të një donacioni mjaftë të rëndësishëm për qendrën tonë ,40 palë mantilla dhe 40 palë kllampe iu janë siguruar stafit të QKMF-se nga kjo kompani.Vullneti i kompanisë Bl Safety Solutions me pronar Suad Bushin nuk mungoi edhe në realizimin e mbajtjes së trajnimit rreth Mbrojtjes dhe Sigurisë në Punë për punëtorët e QKMF-së si dhe çertifikimin e tyre për trajnimin e mbajtur .

Visar Hasallari

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare shpreh falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për donatorin z.Visar Hasallari për dhurimin e uniformave (mantill) për stafin tonë.

Vlerësojmë lart këtë gjest human dhe mbështetje ndaj institucionit tonë QKMF HANI I ELEZIT.

QKMF “Dr.Menduh Kaloshi “ Hani Elezit falemnderon për zemërsisht donatorët të cilët qendrës tonë i dhuruan 6 copë bartëse për pacientë

AKTIVITETET SHENDETESORE 2026

Përmbillet me sukses vaksinimi i nxënësve të klasave të gjashta , janë vaksinuar gjithsej 63 nxënëse femra të moshës 12 vjeçare me vaksinën Human Papilloma Virus (kanceri i qafës së mitrës) .

Tereni është kryer sipas planprogramit të vaksinimit duke e përfshirë këtë grupmoshë në të gjitha shkollat e Komunes tonë .

Poashtu është realizuar edhe vaksinimi i rregullt të difterit Tetanos tek nxënësit vitit 2006/2007.

Falemnderit prindërve, kujdestarëve të klasave dhe drejtorive përkatëse për bashkëpunimin.

Java Ndërkombëtare e Hipertensionit

Parandalimi është hapi më i mirë për një jetë më të shëndetshme

Sot në kuadër të Javës Ndërkombëtare të Hipertensionit zhvilluam një ligjëratë informuese dhe edukative me pacientët lidhur me rëndësinë e kontrollit të tensionit arterial, mënyrën e jetesës së shëndetshme dhe parandalimin e komplikimeve që shkakton hipertensionin. Përmes këtij aktiviteti synuam të rrisim vetëdijesimin për kujdesin ndaj shëndetit dhe rëndësinë e kontrolleve të rregullta mjekësore. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale në bashkëpunim me organizatën Islamic Relief Kosova mbështetën pjesëmarrësit me tensiometër dhe glukometër. Falemnderit të gjithë pjesëmarrësve për interesimin dhe bashkëpunimin. Ligjëruese Dr.Besmira Daci-Topalli dhe Inf.Mirvete Qajani

Aktiviteti edukativ në komunitet për Javën e Hipertensionit

Stafi i QKMF-së në bashkëpunim me QRSHP Ferizaj mbajti aktivitetin për ndërgjegjësimin dhe parandalimin e hipertensionit.

Në aktivitet morën pjesë edhe Dr.Diana Sojeva Jerliu dhe doktoresha Hidajete Halimi, duke ofruar këshilla shëndetësore për qytetarët.

Dita Ndërkombëtare e Tuberkulozit

Me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Tuberkulozit, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik mbajtën një ligjëratë informuese dhe vetëdijesuese për nxënësit e shkollës së mesme Dardania në Han të Elezit .

Qëllimi i kësaj ligjërata ishte rritja e ndërgjegjësimin për tuberkulozin,ku nxënësit patën mundësinë të informohen më gjerësisht për rëndësinë e kujdesit ndaj shëndetit, higjienës personale dhe paraqitjes në institucionet shëndetësore në rast të shfaqjes së simptomave.

Karvani shëndetësor “përSHËNDETje”,

Dje në Komunën e Hanit të Elezit u mbajt Karvani “përSHËNDETje”, një aktivitet i mbushur me energji pozitive, informim dhe promovim të kujdesit për shëndetin.

Gjatë këtij aktiviteti, qytetarët patën mundësi të përfitojnë matjen falas të tensionit të gjakut dhe glikemisë, si dhe këshilla të vlefshme nga profesionistët shëndetësorë për mënyrën se si të kujdesemi më mirë për shëndetin tonë dhe të parandalojmë faktorët e rrezikut.

Ky aktivitet realizohet në kuadër të projektit “Kujdesi shëndetësor i qasshëm dhe cilësor – AQH Project”, i financuar nga SDC dhe i implementuar nga Swiss TPH & KOPF .

Dita Ndërkombëtare e Autizmit

“Ecë me këpucët e mia “ dhe “ Kam shumë për të thënë “ ishin mbishkrimet e fëmijëve që i mbanin në duar, të cilët vizituan sot qendrën tonë për tu njoftuar për së afërmi për shërbimet që ofrohen në këtë institucion

Bashkë me asistentet dhe prindërit e tyre këta fëmijë u mirëpritën nga stafi shëndetësor i QKMF-se.

Dita Ndërkombëtare e Duhanit

Shënohet Dita Ndërkombëtare kundër Duhanit .Ky aktivitet u shënua në ambientet e QKMF-së përmes shpërndarjes së broshurave dhe dhënjes së informatave edukativo shëndetësore nga profesionistët e qendrës tonë për një shëndet sa më të mirë.

Dita Ndërkombëtare e Infermierisë

Ditën Ndërkombëtare të Infermierisë e shënuam edhe ne si qendër me disa aktivitete edukativo - shëndetësore në komunitet ku krahas kësaj dite infermierët e QKMF-së Hani Elezit ,ofruan shërbime te ndryshme falas për qytetarët tanë, si: matjen e sheqerit, matjen e shtypjes së gjakut, matjen e peshës trupore si dhe këshilla shëndetësore!

Kontrollat sistematike mjekësore në Shkollat Fillore e Mesme e Ulët

Janë realizuar kontrollat sistematike në Shkollat fillore e Mesme e Ulët në Hanin e Elezit fsh.Paldenicë , f.sh. Seçishtë dhe f.sh. Gorancë.

Në kuadër të këtij aktiviteti ekipa mjekësore e QKMF-së u kujdesën për 270 -të nxënësit e Kl. I - rë dhe kl. V -të ne edukimin e ruajtjes së higjienës orale ,higjienës trupore ,identifikimin e deformiteteve te boshtit kurrizor ,matja e peshës dhe gjatësisë trupore .

Falemnderojmë ekipën mjekësore për profesionalizmin si dhe menaxherët e shkollave ,mësimdhënesit dhe nxënësit e dashur për bashkëpunimin dhe mikëpritjen .

Vizitat për nëna dhe fëmijë 0-3 vjeç

Gjatë gjashtë mujorit të parë ekipa jonë e QKMF-së ka realizuar 205 vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë.

Dhoma për Edukim dhe Promovim Shëndetësor në QKMF -Hani Elezit.

Dhomës për Edukim dhe Promovim Shëndetësor për sëmundjet kronike jo ngjitëse (diabeti mellitus, hipertensioni arterial dhe astma bronkiale).

Në të është angazhuar stafi i trajnuar nga ekspertët e AQH-së, për ofrimin e shërbimeve shëndetësore qytetarëve me sëmundje kronike jo ngjitëse, sidomos të atyre mbi 65 vjeç gjatë periudhës .

JANAR-QERSHOR janë ofruar mbi 313 shërbime kur secilit prej tyre iu është hapur librezë shëndetësore

“Kujdesi në Grup për Prindërim” në Hani i Elezit. Një mundësi e re dhe mbështetëse për prindërit ka nisur në QKMF-në e Hanit të Elezit. Programi “Kujdesi në Grup për Prindërim”. Ky program i cili zbatohet nga profesionistët e kujdesit parësor shëndetësor në kuadër të Dhomës për Edukim & Promovim Shëndetësor udhëheqet nga Ministria e Shëndetësisë, mbështetet nga UNICEF përmes fondeve të Qeverisë së Luksemburgut dhe nga AMC, synon të fuqizojë prindërit e fëmijëve 0–17 muajsh përmes sesioneve interaktive mujore. Në grupe të vogla, prindërit diskutojnë dhe mësojnë rreth zhvillimit të fëmijës, ushqyerjes, sigurisë, komunikimit, prindërimit pozitiv dhe vaksinimit – gjithmonë të udhëhequr nga profesionistë të shëndetit. Një hap drejt prindërimit të informuar dhe fëmijërisë së shëndetshme!

Gjatë periudhës JANAR- QERSHOR janë ofruar mbi 3 sesione këshilluese për nënat dhe fëmijët e tyre për një shëndet sa më të mirë.

Komuna HANI ELEZIT	Janar 2026	Shkurt 2026	Mars 2026	Prill 2026	Maj 2025	Qershor2026
Shqiptare	10	8	12	11	10	9
Rom						
Ashkali						
Egjiptian						
Te tjere						
Numri total i perfituesve	10	8	12	11	10	9
Numri i vajzave	8	8	11	10	10	8
Numri i çifteve	1	0	1	1	0	1
Numri i grave shtatzena	5	5	6	5	4	4
Numri i lehonave	2	3	4	4	3	2
Vizitë më shumë se 2 herë	4	4	5	4	3	3
Mosha (<18)	0	0	0	0	0	0
Mosha prej 18 deri 30	6	6	5	4	4	3
Mosha prej 31 deri 40	4	2	5	3	5	4
Mosha mbi 41	0	0	1	1	1	1
Fshat	3	3	5	4	4	3
Qytet	7	5	6	6	6	5
Lindje natyrale	2	4	5	4	3	3
Lindje me operacion (S.C)	3	2	3	2	2	2

Vizitë më shumë se 1 herë	5	5	5	4	4	4
Numri i prenatalave të shperndare	4	5	4	0	0	0
Numri i broshurave të shperndara	5	7	4	5	4	4
Referime	0	0	1	0	0	0
<i>Perfshirja e baballarëve</i>	1	0	1	1	0	1
Periudha e Raportimit 2026	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
Raportuesi	B.Bushi	B.Bushi	B.Bushi	B.Bushi	B.Bushi	B.Bushi

Sektori i Mjekësisë Familjare (Orari 8^h -16^h)

Në Sektorin e Mjekësisë Familjare ofrohen këto shërbime shëndetësore:

- Shërbimet laboratorike dhe RTG
- Imunizimi – Vaksinimi
- Shërbimet e triazhimit
- Shërbimet e Stomatologjisë
- Shërbimet mjekësore administrative – SISH (Sistemi i Informimit Shëndetësor) tani online.
- Vizitat shtëpiake për të semuarit paliativ (Të palëvizshëm)
- Vizitat për nëna dhe fëmijë 0-3 vjeq
- Shërbimet – Klasa për nëna dhe fëmijë
- Këshillimorja për sëmundje kronike jo – ngjitëse

Muajt	Kartoteka		Intervenime	
Viti	2025	2026	2025	2026
Janar	3182	1870	2123	1160
Shkurt	2402	1688	1808	967
Mars	2120	1729	1394	885
Prill	2128	2108	2492	1094
Maj	2062	2096	1674	1024
Qershor	2091	2019	1126	1003
Totali	13.985	11.420	10.617	6133

Kontrollat mjekësore nga mjekët e QKMF-së Janar - Qershor 2026

Mjeket	Nr. kontrollave mjekësore
Dr.Bashkim Hazizi	1298
Dr.Dashnimi Ajvazi	622
Dr.Arta Drini	1550
Dr.Valon Hasallari	1616
Dr. Dardan Shaqiri	1592
Dr.Leutrim Zeqiri	616
Dr.Besmira Daci	3024
Dr.Viola Sopa	1102
Totali	11.420

Sektori i shëndetit publik

Analiza e të dhënave, sistematizimi dhe raportimi i rregullt kanë qenë objektivat e realizimit në Njësinë e Sistemit Informativ Shëndetësor (SISH) .

Sektori i Vaksinimit ka kryer vaksinimin e rregullt të të gjitha grupmoshave, të dy gjinive sipas kalendarit të vaksinimit. Vaksinimin e rregullt i fëmijëve deri në moshën 19 vjeçare (sipas kalendarit të vaksinimit) dhe rastet e lëndimit me vaksinën Antitetanike mbi moshën 19 vjeçare si dhe vaksinimin kunder kafshimit te gjarpërit.

Muajt	Vaksinimi		Vizitat për Nëna dhe fëmijë	
Viti	2025	2026	2025	2026
Janar	61	70	49	41
Shkurt	139	124	42	38
Mars	57	78	12	30
Prill	140	77	40	31
Maj	151	174	44	31
Qershor	106	110	39	34
TOTALI	654	633	226	205

Sektori i Diagnostikës

Gjatë kësaj periudhe për analiza Laboratorike dhe Rentgenologjike janë siguruar material i domosdoshëm për punë, kështu që janë ofruar shërbime si kuantitative (sasiore), po ashtu edhe kualitative, (cilësore).

Sigurimi i reagensëve për analiza laboratorike që janë mungesë në listën e barnave esenciale dhe sigurimi i disa medikamenteve dhe materialit shpenzues për mbulimin e shërbimeve shëndetësore janë siguruar nga buxheti komunal. Aparati rentgenit është në funksion të plotë.

Muajt	Laboratori		RTG-ja	
Viti	2025	2026	2025	2026
Janar	478	517	50	47
Shkurt	347	383	51	58
Mars	194	354	47	59
Prill	244	359	52	50
Maj	323	388	52	37
Qershor	309	384	25	69
Totali	1895	2385	277	320

SEKTORI I STOMATOLOGJISE

Gjatë kësaj periudhe për sektorin e Stomatologjise janë siguruar material i domosdoshëm për punë, kështu që janë ofruar shërbime si kuantitative (sasiore), po ashtu edhe kualitative, (cilësore).

Muajt	Viti	Viti
Viti	2025	2026
Janar	69	110
Shkurt	112	92
Mars	54	77
Prill	89	78
Maj	99	70
Qershor	58	74
Totali	481	501

Sektori i Emergjencës

Ky sektor ka ofruar shërbime 24/7, i cili ka qenë një nga prioritetet në organizimin, menaxhimin dhe furnizimin me medikamente dhe material shpenzues si: shiringa, gjilpëra, material për fashim. Për menaxhim të rasteve në këtë sektor shërbimet janë ofruar edhe jashtë QKMF-së, dhe rastet emergjente që iu referohen nivelit sekondar dhe terciar, sipas thirrjeve nga ana e pacientëve, po ashtu edhe zyrtarëve policor dhe institucioneve në menaxhimin e emergjencave.

Muajt	Emergjenca		Vizitat shtëpiake	
Viti	2025	2026	2025	2026
Janar	2892	1394	186	107
Shkurt	1876	1812	105	62
Mars	1531	1902	66	97
Prill	1881	1698	182	92
Maj	1362	2379	145	142
Qershor	1191	1857	121	99
Totali	10.733	11.042	805	599

Shërbimet në Ambulancën e Mjekësisë Familjare në Gorancë

AMF Gorancë ofron shërbime shëndetësore dy herë gjatë javës (të martën dhe të enjten nga ora 08:00-12:00..Ekipa e cila punon gjatë terrenit në AMF është e përbërë nga mjeku dhe infermieri i QKMF-se .

Muajt	Kontrollet mjekësore		Intervenime		Vizitat Shtëpiake		Vizitat për Nëna dhe fëmijë	
Viti	2025	2026	2025	2026	2025	2026	2025	2026
Janar	25	15	5	8	0	2	00	00
Shkurt	16	22	5	10	0	2	00	00
Mars	17	70	7	33	1	2	00	00
Prill	11	68	6	18	1	2	00	00
Maj	25	72	7	20	2	5	00	00
Qershor	11	70	6	15	1	0	00	00
Totali	105	317	35	104	5	13	00	00

Rastet e sëmundjeve malinje në Komunën tonë

Mbiemri	Gjinia	Numri personal	Viti i lindjes	Vendi i lindjes (Komuna)	Lokalizimi primar i kancerit	ICD - O kodi
KALISI	F	1004505227	1979	NEQAFC	disc.mamae sin	C 50
LOKU	F	1004430600	1965	H.ELEZIT	SIGMA	C 18
CURRI	M	1001496910	1951	H.ELEZIT	PROSTAT	C 61
HASALLARI	F	1004435784	1949	H.ELEZIT	Ca mammae	C 50

Raport lidhur me mbarevajtjen e Edukimit të Vazhdueshem Professional për vitin kalendarik 2026

Qendra trajnuese e mjekësisë Familjare Hani Elezit ka hartuar planin e aktiviteteve trajnuese për infermier dhe profesionistë tjerë shëndetësor pranë QKMF Hani Elezit, me qëllim që të arrihen objektivat e zhvillimit profesional drejt ngritjes dhe plotësimit të standardeve për kujdes shëndetësor. I tërë ky aktivitet është realizuar për të rritur vetbësimin në shërbimet infermirore dhe natyrisht përmes kësaj edhe lehtësimin e marrjes së vendimeve tek profesionistët shëndetësor, njëherësh do të fitohen edhe pikët akredituese për infermier që ju nevojiten për rilicencim. Gjithsej janë mbajtur 6 ligjerata të cilat janë të akredituar nga Bordi për Edukim të Vazhdueshëm profesional dhe të miratuara nga Oda e infermiereve të Kosovës, deri në fund të vitit janë edhe 4 ligjerata me të cilat mbyllet planprogrami për vitin kalendarik 2025. Në fund të trajnimit të gjithë pjesëmarrësit do të pajisen me certificate të nënshkruar nga Bordi për EVP. Numri i përgjithshëm i infermiereve të cilët kanë ndjek ligjeratat janë rreth 33 infermier dhe profesionist të tjerë.

Të hyrat vetanake në QKMF dhe QPS gjatë periudhës Janar – Qershor 2026

Kodi	Përshkrimi	Realizimi 2025	Planifikimi 2026	Diferenca
50019	Taksa për shërbimet sociale	73.00	147.00	(74.00)
50409	Participimet në shëndetësi	2,378.40	4,018.95	(1,640.55)
50024	Taksa për certifikata mjekësore	555.00	1,035.00	(480.00)
730	Shëndetësia dhe MS	3,006.40	5,200.95	(2,194.55)

Barnatorja Qendrore

Furnizimi i rregullt me barna, material esencial dhe hargjues nga Ministria e Shëndetësisë dhe kompania e kontraktuar nga Komuna sipas kërkesave dhe planifikimeve.

Gjatë muajve Janar - Qershor 2026 në QKMF, Menduh Kaloshi “ janë furnizuar gjithësej 91 pacient, me këto lloje të insulinave.

Muaji	Ins. Novomix	Ins. Novorapid	Ins. Levemir
Janar	51	20	11
Shkurt	41	19	13
Mars	44	20	17
Prill	47	19	10
Maj	45	17	12
Qershor	51	16	13
Totali	279	111	76

RAPORTI GJASHTËMUJOR I QENDRËS PËR PUNË SOCIALE 2026

Gjatë periudhës Janar- Qershor 2026 Qendra për Punë Sociale ka kryer detyrat e zakonshme që i përkasin këtij institucioni. Zyrtarët e QPS-së kanë mbajtur takime dhe punëtori për Shërbime Sociale dhe për Skemën e Ndihmës Sociale. Bashkëpunim me Policinë e Kosovës, Gjykatat, Prokurorinë, Qendrat për Punë Sociale, Departamentin për Politika Sociale dhe Familjare, Shkolla, QKMF, OSBE, KFOR OJQ etj. Pjesëmarrja si anëtarë në komison vlerësues tek fëmijët me nevoja të veçanta në shkolla. Kemi pasur takime dhe trajnime të ndryshme si për trajtimin, integrimin dhe rehabilitimin e personave të radikalizuar, Sistemin e Ri të Pilotimit të Reformës së Ndihmës sociale, Mbrotjen e fëmijëve, Integrimin e Personave të Riatdhesuar etj. Kemi vazhduar së zbatuari pilotimin e reformes së ndihmës sociale. Kemi pasur një bashkëpunim dhe përkrahje nga organizata të ndryshme për të i ndihmuar familjet në nevojë me pako ushqimore e mish, veshmbathje dhe dhurata.

Në formë tabelare do të paraqesim punën e dy shërbimeve të Qendrës për Punë Sociale në Han të Elezit:

SKEMA E NDIHMËS SOCIALE

Muaji	Nr. i familjeve përfituese		Arsyetimi
	2025	2026	
Janar	89	80	
Shkurt	87	75	Nderprerje përmes ATK, mos riaplikime.
Mars	81	73	Nderprerje përmes ATK, mos riaplikime.
Prill	83	75	
Maj	81	76	
Qershor	84	74	

Pasqyra tabelare për Skemën Sociale

Shërbimet	2025	2026
Numri i aplikuesve të rinj	3	2
Lëndët dërguar për Komision Mjekësor	42	42
Lëndë të refuzuara nga komisioni mjekësor	03	02
Lëndë të kërkuara për plotësim dokumentacioni nga mjeku	1	0
Lëndët e aprovuar nga Komisioni Mjekësor	42	40
Lëshim të kartonëve të ndihmës sociale	24	23
Verifikim të familjeve që kanë aplikuar dhe riaplikuar për ndihmë sociale	63	55
Riaplikime dhe aplikime për ndihmë sociale	56	60
Vërtetime që gjenden si shfrytëzues i ndihmës sociale	0	1

Konsultim për plotësim dokumentacioni, riaplikime dhe aplikime për ndihmë sociale	31	36
---	----	----

SHËRBIMET SOCIALE

Përshkrimi	2025	2026
Trafikim i qenieve njerëzore	0	0
Përdorimi i substancave narkotike	0	0
Propozim për regjistrimin të mëvonshëm të fëmijëve	0	0
Vërtetim që nuk i është hequr zotësia e punës dhe e veprimit	32	25
Propozimi Gjykatës themelore për besimin e fëmijëve	1	0
Përkujdesje institucionale e të moshuarve në shtëpi të moshuarve	1	1
Fëmijë me sjellje asociale, Të miturit në konflikt me ligjin	10	26
Vërtetim që nuk është shfrytëzues i ndihmave sociale	16	2
Dhunë në Familje	4	1
Sanim të marëdhënies bashkëortore	0	1
Mbikqyrje e shtuar nga Organi i Kujdestarisë për të miturit	2	0
Aplikime për fëmijët me aftësi të kufizuara	2	0
Pagesa për Fëmijët me aftësi të kufizuar	26	27
Pagesa për Fëmijët në strehim familjar brenda familjes biologjike dhe jashtë familjes biologjike	4	4
Prindërit e aprovuar për adoptim vendor të fëmijut	1	0
Braktisje të fëmijut	0	0
Vërtetim për fitim dhe humbje të shtetësisë	0	9
Konstatime zyrtar	1	1
Përfaqësim i palës në Gjykatë	2	0
Mbrojtja e viktimës së mitur në stacion policor	0	13
Këshillime psiko-sociale	20	21
Kontaktim fëmijë-prind	1	0
Vizita familjare	13	24
Caktimi i kujdestarisë për të miturit	0	0
Pëlqim për udhëtim jashtë vendit	0	1
Pëlqim për bartje të pasurisë	0	1
Fëmijët me forma të rënda të punës	0	0

Adoptim te femijeve pa perkujdes prindëror	0	0
Perkujdesje ndaj personave te moshuar	1	1
Viktima te krimit seksual	0	0
Ndihmë dhe trajtim personave të rritur me Aftesi te kufizuara	0	3
Dergimi i lëndëve në Gjykatë	11	6
Njoftime dhe kërkesa nga gjykatat. prokuroritë për fillim procedurave, marrja e masave etj.,	10	17
Njoftime, shkresa me QPS-së dhe institucione tjera komunale e shëndetësore	10	3

KIMETE KUKA – HASALLARI

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK DHE TURIZËM

Gjatë periudhës Janar-Qershor të vitit kalendarik 2026, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm ka marrë pjesë në të gjitha takimet, konferencat dhe punëtoritë që i përkasin sferës së zhvillimit ekonomik dhe atij turistik me interes për Komunën e Hanit të Elezit. Gjatë gjashtëmujorit të parë në këtë departament janë realizuar këto aktivitete:

- Janë mbështetur bizneset fillestare dhe ato ekzistuese të vogla me subvencione, ku vlera e të gjithë thirrjes ishte 25,000.00 euro, vlerë nga e cila kanë përfituar 10 biznese.
- Kanë vazhduar punimet e projektit kapital “Rregullimi i krojeve publike në Han të Elezit dhe në fshatrat: Dromjak, Seçishtë, Krivenik, Dimcë, Paldenicë, Pustenik dhe Rezhancë”, të ndarë në dy LOT-e: Lot I: Rregullimi i parkut tek Pishat në fshatin Gorancë & Lot II: Renovimi i bunkerit dhe kthimi i tij në muze.
Këta dy projekte janë vazhdimësi nga viti i kaluar dhe gjatë këtij viti planifikohet të fillojnë edhe fazat e dyta.
- Është hartuar projekti i kthimit të brendësisë së trenit në muze tek Parku Memorial, hartimi i të cilit ka kushtuar 25,000.00 € dhe është financuar nga AMMKM në kuadër të marrëveshjes me ta. Implementimi i këtij projekti do të kushtojë 2,8 milion €.
- Është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me organizatën Preda Plus për implementimin e projektit “E Ardhmja e Saj”, ku përveç trajnimeve do të shpërndahen edhe grante në fund të ciklit që do ta implementojë organizata.
- Ka filluar procesi i përgatitjes së dokumentit për shqyrtimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik pas kërkesës nga MAPL për harmonizim me Strategjinë Kombëtare.

SEKTORI I TAKSAVE PËR USHTRIM TË VEPRIMTARISË

Gjjobat				0
Aktvendimet dhe shpërndarja e tyre tek subjektet aktive				361
Faturat e lëshuara gjatë viti 2026				18
Faturimi për Janar-Qershor 2026				96,783.48
Inkasimi për Janar-Qershor 2026				65,563.20
Përshkrimi	Periudha Kohore	Viti 2026	Viti 2025	
TAKSË PËR USHTRIM TË VEPRIMTARISË	Janar-Qershor	65,563.20	73,702.88 €	

QENDRA PËR REGJISTRIM TË BIZNESEVE

○ APLIKIME PËR BIZNESE TË REJA

Përshkrimi	Lloji	Numri	Totali 2025	Gjinia
Regjistrim biznesi	Biznese individuale / B.I	17	17 B.I	17 / M

Regjistrim biznesi	Biznese Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara / SH.P.K	03	03 Sh.P.K	3 / F
--------------------	--	----	-----------	-------

○ **APLIKIME PËR SHUARJE TË BIZNESEVE**

Përshkrimi	Lloji	Numri	Totali 2025	Gjinia
Shuarje të bizneseve	Biznese individuale / B.I	2	2 B.I	0 F
Shuarje të bizneseve	Biznese Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara / SH.P.K	0	0 SH.P.K	2 M

○ **APLIKIME PËR NDRYSHIME NË BIZNES**

Përshkrimi i shërbimit	Totali
Kërkesë për informata	34
Kërkesë për ndryshimin e pronarëve /aksionarëve	02
Kërkesë për shtimin apo heqjen e aktivitetit	05
Kërkesë për ndryshim të adresës	01
Kërkesë për ndryshimin e drejtorit apo përfaqësuesit të autorizuar	03
Kërkesë për ndryshim të emrit tregtarë	02
Kërkesë për ndryshim të bordit	0
Kërkesë për shuarje të njësisë	0
Kërkesë për certifikatë dublikat	03

MAJLINDA KALOSHI

Drejtorja për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË

Raporti përmbledhës i punës gjashtëmujore në kuadër të drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë ka për qëllim të raportimit për kryetarin e komunës, informimin e opinionit publik për punën e DSHPE-së për periudhën Janar -Qershor 2026. Ky raport është një raport përmbledhës dhe njëherit paraqet punën e përgjithshme të kësaj drejtorie të cilat në një formë apo tjetër kanë ndikuar në jetën e qytetarit. Të gjitha aktivitetet e poshtëshënuara janë realizuar në bashkëpunim të plotë me kryetarin e Komunës dhe drejtorit tjera komunale.

Aktivitetet e Drejtorisë:

- **Kontratat e realizuara dhe në proces të realizimit nga DSHPE:**
- Mirëmbajtja e ndriçimit publik në zonën urbane dhe rurale të Hanit të Elezit në vlerë prej **13,767.00 € (në proces të realizimit)**
- Zhbllokimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik në vlerë prej **3,512.00 i përfunduar €**
- Shërbime saldimi (Mirëmbajtja e shportave, ulëseve, shenjave të dëmtuara, shtyllave në shumë prej **4,060.00 € (në proces)**
- Shtrirja e ndriçimit publik në zonën Urbane dhe Rurale të Hanit të Elezit në vlerë prej **16,550.40 €** në ne fshatrat Pustenik, Dimce, Gorance, Krivenik, Seqishte, Rezhançe, Paldenice dhe Dërmjak (**në proces të vlerësimit**)
- Shtimi i kapaciteteve të ujit dhe rregullimi i ujësjellësit në Fabrikën e ujësjellësit të Dimcës në vlerë prej **10,000.00 € (në proces të tenderimit)**
- Shtrirja e ndriçimit publik në zonën Urbane dhe Rurale të Hanit të Elezit në shumë prej **100.000.00€ (në proces të tenderimit)** në këtë procedurë të nderimit planifikohet që të shtrihet ndriçimi publik në rr. Adem -Jashari -11 qershori, të vendosen trupat ndriçues të mençura (smart) nëpër qytet, të ndërrohen të gjitha trupat ndriçues ata të vjetër të cilat janë me poqe dhe të vendosen trupa ndriçues Led të cilët janë mbi 800 sosh në tërë territorin e Hanit të Elezit, për asrye të ngarkesës së rrjetit planifikohet që të ndahen me orëmatës të veçante në mbi 20 ndarje dhe punë të tjera të ndriçimit.
- Mirëmbajtjen e rrugëve Verore-Dimërore duke u bazuar në marrëveshjen në mes komunës dhe kompanisë NPL Pastrimi SH.A në shumë prej **83,850.55 € (në proces të realizimit), ku deri më 01.06.2026 janë paguar 49,366.47 ose 58.9 % e marrëveshjes,**
- Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit të Dimcës në rrugët; Dëshmorët e Kombit, Xhemsedin Suma, Imer Vila, Adem Jashari-rruga në drejtim të kufirit, , ku ky projekt është duke u realizuar nga kompania Bifurkacioni
- Lirimin e hapësirave publike në disa prona nga zyrtari i hapësirave publike (Goranc, rr. Hysen suma)

Aktivitetet tjera,

- Bashkëpunim të ngushtë me kompaninë lokale të mbeturinave “NPL Pastrimi Sh.a”, duke pas parasysh edhe mirëmbajtjen e rrugëve Verë-Dimër, mirëmbajtjen e hapësirave publike, varrezave të Dëshmorëve etj.
- Inspektimet e punimeve në teren bashkë nga Inspektorët e Drejtorisë së DSHPE-së,
- Aktivitetet e ndërmarra për nderë të 11 Qershorin ditës së Çlirimit,
- Mirëmbajtjen e rregullt të ujësjellësit publik të Dimcës dhe rregullimin e defekteve në bashkëpunim me njësinë e bifurkacionit në Han të Elezit,
- Rregullimin dhe mirëmbajtjen e shenjave të komunikacionit,

- Mirëmbajtjen e kanalizimit fekal dhe atmosferik nga kompania e kontraktuar,
- Mirëmbajtjen e panove reklamuese dhe antenave për kryerjen e pagesave për shfrytëzimin e pronës publike duke u bazuar në rregulloren për taksa dhe tarifa administrative.
- Hartimin e planit ndër komunal për menaxhimin e mbeturinave në regionin e Ferizajt dhe Gjilanit,
- Dërgimin e shkresës në Ministrinë e Infrastrukturës, Infrakos dhe akterëve tjerë të përfshirë në projektin “Rehabilitimi i Hekurudhës” për rregullimin e defekteve në rrugën Adem Jashari-Imer Vila te vendi i quajtur Dheu i Bardh ku pas insistimit nga Drejoria e DSHPE-së , kanë filluar rregullimin e dëmtimeve të cilat i kanë shkaktuar.

RAPORTI SIPAS DEPARTAMENTEVE DHE STATUSI I ZGJIDHJES

Rastet Mortore					
Viti	01.01.2025-01.06.2025		01.01.2026-01.06.2026		Diferenca
	GJ	Raste mortore	GJ	Raste mortore	
Të vdekur	20	20	18	18	2

Shkurtesa	Përshkrimi	Pranuar	Në Proces	Miraturar	Refuzuar	Hedhur poshtë	pezulluar	ceduar	anuluar	Përfunduar	Totali
D SHPE	Drejtoria e shërbimeve Publike dhe Emergjencë	50	03	47	00	0	0	0	00	0	50
		50	03	47	00	0	0	0	00	0	50

INKASIMET JANAR –QERSHOR 2026	SHUMA	DIFERENCA
Vlera e inkasuar për këtë gjashtë mujorë nga sektori i shërbimeve publike dhe komunikacionit për vitin 2025 është	5409.70	Diferenca 2025-2026
Vlera e inkasuar për këtë gjashtë mujorë nga sektori i shërbimeve publike dhe komunikacionit për vitin 2026 është	4269.70	-550 më pak
Pagesa për regjistrimin e autotakxive	590.00€	
Totali i te hyrave per periudhen Janr-Qershor 2026 eshte	4859.70 €	

➤ NJËSIA E ZJARRFIKSËVE DHE SHPËTIMIT

Aktivitetet:

2026	Nr. I daljeve	Nr.i zjarreve	Nr. I daljeve Teknike	Nr. I shërbimeve	Aksidente rrugore	Vershime	Te rejshme	Të lënduar			Të vdekur		
								zj.	qyt.	tot	zj.	qyt.	tot
Janar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shkurt	4	3	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Mars	2	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Prill	6	6	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Maj	2	0	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Qershor	7	3	0	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Korrik													
Gusht													
Shtator													
Tetor													
Nëntor													
Dhjetor		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjithsej	25	18	0	7	0	0	0	0	0	0	0	0	0

➤ SEKTORI I KOMUNIKACIONIT

Për periudhën Janar –Qershor 2026 ka pasë inspektime të vazhdueshme në zonën kufitare ku janë inspektuar taksistët dhe është bërë identifikimi taksistëve ilegal që operojnë në atë pjesë dhe janë detyruar të regjistrohen, numri Inspektimeve për këtë periudhë është mbi 100 inspektime, po ashtu janë kryer inspektime së bashku me inspektorët tjerë në fushat tjera duke përfshirë ambientin .Gjatë këtij gjashtë mujori inspektori i komunikacionit ka qenë i angazhuar dhe si mbikëqyrës I një kontrate me titull, Mirëmbajtja e ndriçimit publik në zonën urbane dhe rurale në Hanë të Elezit i cili projekt është në proces të realizimit. Gjithashtu gjatë këtij gjashtë mujori kemi bërë edhe rregullimin e disa shenjave të dëmtuara të komunikacionit.

Për këtë periudhë kemi të regjistruar 20 taksistë dhe 1 operator dhe dy Vërtetime të rendit udhëtimit.

➤ AKTIVITETET NGA INSPEKTORI I NDËRTIMIT

Raport për muajin **Janar –Qershor** mbi punën në teren dhe inspektimet e punës të cilat janë duke u kryer nga data: **01.01.2026 deri 30.06.2026**

	AKTIVITETET	Numri i Lëndëve
1	Vërejtje me shkrim për ndërtimet në teren me gojë dhe me shkrim.	06
2	Procesverbale.	02
3	Vendim për ndërtime pa leje	0
4	Urdhëresë	0
5	Inspektime të punimeve në teren.	06
6	Përgjigje në kërkes	0
7	Lista e lejeve ndërtimore	02
8	Asistenc Policore	0

SENAD KALISI

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ka zhvilluar një sërë aktivitete në kuadër të përgjegjësisë së saj, me fokus në mbështetjen e fermerëve, përgatitjen e dokumentacionit dhe raporteve, si dhe bashkëpunimin me institucione dhe organizata të ndryshme.

Aktivitetet kryesore të realizuara gjatë kësaj periudhe janë:

- Është përgatitur **Raporti i Punës i DBPZHR-së për vitin 2025**, me të dhënat dhe aktivitetet e realizuara nga drejtoria gjatë vitit paraprak.
- Janë zhvilluar **takime dhe janë parashtruar kërkesa te shoqata dhe organizata të ndryshme**, si TIKA, IRK, KATARI, LAB, MËSHQERRA, KDC, etj., me qëllim të sigurimit të mbështetjes për fermerët e Komunës sonë përmes pajisjeve të ndryshme bujqësore.
- Janë formuar komisionet përkatëse, përkatësisht: **Komisioni për Ndërrim-Destinim të Tokës Pyjore në Tokë Ndërtimore, Komisioni për Vlerësimin e Dëmeve nga Ariu dhe Komisioni për Korrje-Shirje 2026 për drithërat e bardha.**
- Janë përgatitur raportet për **sipërfaqet e ujitura, sipërfaqet e mbjella pranverore**, si dhe Raporti i Gjuetisë 2025–2026 për Vendgjuetinë “Kroni i Ftohtë” – Hani i Elezit, të cilat janë përgatitur për nevojat e MBPZHR-së.
- Janë përgatitur **raportet për subvencionet komunale për tri vitet e fundit, 2023–2025**, në kuadër të nevojave të Projektit EREA.
- Është përgatitur raporti për **subvencionet komunale dhe subvencionet e MBPZHR-së për periudhën 2023–2025**, për nevojat e Hartës Zonale.
- Është realizuar **aplikimi i fermerëve për subvencionet direkte në AZHB**, për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025, për kategoritë e viçave dhe qumështit, duke u ofruar fermerëve mbështetje gjatë procesit të aplikimit.
- Në bashkëpunim me **Shoqatën TIKA**, janë shpërndarë **20 motokultivatorë me frezë** për fermerët, me qëllim të mbështetjes së tyre dhe lehtësimit të punëve bujqësore.
- Është marrë pjesë në **formimin e Kolegjiut të Bujqësisë pranë Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK)**, me qëllim të bashkëpunimit dhe koordinimit të çështjeve që lidhen me sektorin e bujqësisë në nivel lokal.
- Është marrë pjesë në punëtorinë **“Menaxhimi i Qëndrueshëm Lokal i Popullatës së Qenve”**, të organizuar nga Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve dhe AUVK-ja.
- Gjatë kësaj periudhe janë realizuar edhe **vizita në terren**, me qëllim të përcjelljes së situatës në terren dhe verifikimit të çështjeve që lidhen me aktivitetet dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

ABDURAMAN BUSHI

Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Gjatë gjashtëmujorit të parë në drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport janë realizuar këto aktivitete:

Shpallja e Sportistëve të Vitit

U organizua ceremonia e nderimit të sportistëve dhe ekipeve më të dalluara të komunës. Ky aktivitet shërbeu për të motivuar të rinjtë dhe për të vlerësuar arritjet e tyre në fushën e sportit.



Turneu Ndërkombëtar i Volejbollit

Me rastin e Ditës së Pavarësisë u mbajt turneu ndërkombëtar i volejbollit me pjesëmarrjen e ekipeve nga vende të ndryshme. Aktiviteti promovoi sportin, miqësinë ndërkombëtare dhe respektin për këtë ditë historike.



Manifestimi për Pavarësinë

Në Qendrën e Kulturës “Imri Curri” u zhvillua koncert festiv për shënimin e Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës me këngë e valle tradicionale, i shoqëruar me fjalë rasti nga Kryetari i Komunës.



Aktivitete Përkujtimore

U organizuan homazhe dhe vizita te varrezat e dëshmorëve, duke shprehur respekt dhe mirënjohje për sakrificën e tyre për lirinë e vendit.



Festivali Folklorik – Edicioni IV



Ngjarja më e rëndësishme kulturore e vitit. Shoqëri artistike nga rajone të ndryshme prezantuan valle, këngë dhe tradita popullore. Festivali u zhvillua në tri netë dhe përfundoi me ndarjen e çmimeve për ansamblet pjesëmarrëse, duke ruajtur e promovuar trashëgiminë kulturore.

Ditët e Kulturës

U organizuan aktivitete te ndryshme sportive ne futboll, ping-pong, badminton, hiking dhe kros. Aktivitetet shërbyen për të promovuar frymën e bashkpunimit dhe disiplinën sportive tek të rinjtë.



Aktivitete Kulturore për Fëmijë

U shfaq pjesa teatrale “Thesari i Fshehur” për fëmijë, e cila u prit me interesim të madh. Aktiviteti ofroi një program edukativ dhe argëtues për moshat e reja, duke pasuruar jetën kulturore të komunitetit.



Projekti “Drejt Malit”

Në Brezovicë u realizuan ecje malore dhe aktivitete sportive në natyrë. Projekti synoi edukimin e të rinjve për një mënyrë jetese të shëndetshme dhe ndërgjegjësimin për ruajtjen e mjedisit.

Biblioteka Komunale Hani i Elezit

Biblioteka Komunale e Hanit të Elezit gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 ka zhvilluar një sërë aktiviteteve kulturore dhe edukative me qëllim promovimin e leximit dhe pasurimin e fondit të librave. Gjatë kësaj periudhe, fondi i bibliotekës është zgjeruar me donacione të reja librash nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës dhe qytetarë të komunës, duke arritur në 7,823 tituj në gjuhë të ndryshme. Janë evidentuar 35 lexues aktivë, të cilët kanë lexuar mbi 90 tituj, duke dëshmuar rritje të vazhdueshme të interesit për leximin.

Në kuadër të aktiviteteve kulturore, biblioteka ka organizuar takime me nxënësit e shkollave, lexime të hapura dhe diskutime mbi rëndësinë e librit. Më 23 prill, në Ditën Botërore të Librit, nxënësit e shkollës “Ilaz Thaçi” vizituan bibliotekën, duke e kthyer këtë ditë në një festë të dijes dhe kulturës.

Biblioteka Komunale e Hanit të Elezit mbetet e përkushtuar në misionin e saj për të nxitur leximin, edukimin dhe kulturën në komunitet.

ARBENITA BAJRAMALIU

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



05/ Nr. 7616 / 2026

DATA	12.08.2026
PËR	KPF dhe Kuvendin e Komunës
PËRMES	Mehmet Ballazhi Kryetar i Komunës
NGA	Hisni Luri Drejtör për Arsim
LËNDA	Propozim për ndryshimin e rregullores për taksat komunale 2025



Të nderuar

Me anë të kësaj shkrese ju përcjellim propozim për ndryshimin e rregullores për taksat komunale 2025.

Me respekt!

Propozimi për ndryshimin e rregullores për taksat Komunale 2025,

Neni 9

DREJTORIA PËR ARSIM KULTURË RINI DHE SPORT
Pjesa 2

Ligji mbi edukimin parashkollor (Ligji nr. 02/L-52), Neni 18, neni 22,

Taksat për fëmijët në qerdhe.

Neni/pika	TAKSA	Shuma aktuale	Shuma e propozuar
9.1	Taksë mujore për një fëmijë në qerdhe	40.00 €	50.00€
9.2	Taksë për dy fëmijë	60.00 €	80.00€
9.3	Taksë për fëmijën e tretë e më shumë	(Falas)	(Falas)



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



05/ Nr. 7592 2026

DATA	12.08.2026
PËR	KPF dhe Kuvendin e Komunës
PËRMES	Mehmet Ballazhi Kryetar i Komunës
NGA	Hisni Luri Drejtor për Arsim
LËNDA	Propozim për ndryshimin e rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve

Të nderuar

Me anë të kësaj shkrese ju përcjellim propozim për ndryshimin e rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.

Me respekt!



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 neni 11, 12.2 shkronja (c), 17, 40.2 shkronja (a), Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë Nr. 03/L-048 neni 17 paragrafi 1 dhe 2, Rregullorja Financiare Nr.01/2013-MF – Shpenzimi i Parave Publike neni 36 pika 3, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit 01/Nr.4240/2023 neni 24, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës neni 15.1 shkronja (a), Kuvendi i Komunës me datën 30.09.2024 miratoi:

RREGULLORE PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT E NDARJES SË SUBVENCIONEVE

Neni 1 Qëllimi dhe Fushëveprimi

1.1 Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat të cilat i mundësojnë Komunës të ndajë mjete financiare pa kthim nga kategoria e subvencioneve për fushat e cekura në këtë rregullore për personat fizik dhe juridik.

1.2 Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen nga organet dhe trupat komunale gjatë ndarjes së subvencioneve për përfituesit

Neni 2 Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

2.1 **Subvencionet** - për kuptim të kësaj rregullore përfshijnë transferet e njëanshme, të pakthyeshme të mjeteve buxhetore të institucionit, në llogarinë rrjedhëse të përfituesve, të ardhurat e të cilëve nuk mbulojnë shpenzimet e caktuara përkatëse për arritjen e një qëllimi të ligjshëm për interes publik

2.2 **Pagesa e pakthyeshme** - është e njëanshme atëherë kur nuk ka mallra dhe shërbime që rrjedhin si kompensim ose kundërvlerë për pagesën.

2.3 **Përfituesi** - nënkupton personat fizik dhe juridik që përfitojnë mjete financiare nga kategoria e subvencioneve të planifikuara në Buxhetin e Komunës dhe në pajtim me Ligjin për ndarjet buxhetore.

2.4 Banor rezident - nënkupton personi që jeton dhe vepron në Komunë dhe posedon dokumentacion valid të Republikës së Kosovës.

Neni 3 **Limitet buxhetore**

Komuna ndan subvencione duke u bazuar në Ligjin e buxhetit për vitin fiskal për të cilën ndahen subvencionet dhe vetëm në masën e përcaktuar në këtë ligj.

Neni 4 **Rregullat e përgjithshme të aplikimit për subvencione**

4.1 Komuna mund të bëjë ndarje të subvencioneve për persona fizik dhe juridik mbi bazën e kërkesës së tyre dhe në pajtim me dispozitat e kësaj rregullore.

4.2 Personi fizik dhe juridik mund të jetë përfitues i subvencioneve të ndara nga Komuna nëse i ka të përfunduara obligimet ndaj Komunës.

4.3 Kushtëzimi me përfundimin e obligimeve ndaj institucioneve tjera të personit fizik dhe juridik mund të përcaktohet sipas fushave specifike nga vetë Komuna.

Neni 5 **Procedurat e përgjithshme për ndarjen e subvencione**

5.1 Procedura e ndarjes së subvencioneve nga Komuna mund të zhvillohet mbi bazën e thirrjes publike apo në raste të veçanta në bazë të kërkesës së arsyetuar atëherë kur lejohet me dispozitat e kësaj rregullore.

5.2 Gjatë ndarjes së subvencioneve përmes thirrjes publike të Komunës përcaktohet qartë fusha e subvencionimit, kriteret, dokumentet e nevojshme për aplikim dhe informata tjera me rëndësi.

5.3 Shqyrtimi i kërkesave dhe ndarja e subvencioneve mbi bazën e thirrjes publike zhvillohet sipas procedurave të parapara në nenin 9 të kësaj Rregullore.

5.4 Shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave për ndarje të subvencioneve jashtë thirrjes publike të Komunës bëhet brenda 30 ditë kalendarike nga parashtrimi i kërkesës.

Neni 6 **Përjashtimet nga ndarja e subvencioneve**

6.1 Personi fizik apo juridik vetëm një herë në vit mund të jetë përfitues i subvencioneve të ndara nga Komuna, nëse aktiviteti i individit ose institucionit është në interes edhe të komunës mund të përfitoj subvencion.

6.2 Përjashtim nga paragrafi 1 i këtij Neni bëjnë subvencionet e ndara për persona fizik në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale dhe raste emergjente.

6.3 Nëse me fajin e përfituesit nuk përmbushen obligimet e përcaktuara në vendimin apo me marrëveshjen për ndarjen e subvencioneve, për 5 (pesë) vitet e ardhshme përfituesi humb të drejtën në përfitim nga secila kategori e subvencioneve.

Neni 7

Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve

7.1 Kryetari i Komunës emëron komisione të përkohshme për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve në përbërje të përfaqësuesve nga fushat specifike.

7.2 Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve veprojnë në pajtim me parimet e përgjithshme të ligjshmërisë dhe konform autorizimeve, që jepen nga Kryetari i Komunës.

7.3 Kryetari dhe anëtarët e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve duhet të jenë shërbyes civil të Komunës.

7.4. Përbërja e komisionit duhet të jetë prej 5 anëtarëve, dy nga drejtoria përkatëse, një zyrtar financiar, një nga një drejtori apo sektor tjetër, dhe një nga shoqëria civile.

7.5 Përbërja e Komisionit duhet të bazohet mbi parimin e barazisë gjinore.

7.6 Anëtarët e Komisionit për vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve mbajnë përgjegjësinë për zbatimin e drejtë të kriterëve për ndarje të subvencioneve.

Neni 8

Vlerësimi i kërkesave dhe vendimmarrja

8.1 Komisioni bënë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve brenda afatit prej 15 ditë pune pas përfundimit të afatit të shpalljes publike.

8.2 Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve veprojnë në pajtim me legjislacionin për financat publike dhe dispozitat e kësaj rregulloreje si dhe legjislacionin në fuqi.

8.3 Rekomandimet e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.

8.4 Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e saj i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit.

8.5 Komisioni i rekomandon Kryetarit të Komunës listën e përfituesve të subvencioneve në përputhje me kriteret e përcaktuara në shpalljen publike për ndarjen e subvencioneve dhe në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje si dhe i rekomandon marrjen e vendimit për ndarje të subvencioneve.

8.6 Kërkesat që nuk i plotësojnë kriteret për subvencione do të refuzohen nga Kryetari me rekomandim të Komisionit.

8.7 Komuna i njofton sa më shpejt që është e mundur të gjithë aplikuesit në baza individuale për përfshirjen ose jo në listën e përfituesve të subvencioneve dhe i njofton për të drejtën dhe procedurën e parashtrimit të ankesës.

8.8 Kryetari mund të kërkojë që Komisioni për vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve të bëjë rivlerësimin e kërkesave apo të anulojë gjithë procesin e vlerësimit dhe të caktojë komision të ri për vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve.

8.9 Kryetari merr vendim për ndarjen e subvencioneve, në përputhje me rekomandimin e Komisionit, në afat prej 5 ditë pune pas përfundimit të afatit të paraqitjes së ankesave të përcaktuar sipas Nenit 10 të kësaj Rregulloreje.

Neni 9

Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve

9.1 Kryetari i Komunës emëron komisione me mandat (4) katër vjeçar për shqyrtimin e ankesave për ndarje të subvencioneve në përbërje të përfaqësuesve nga fushat specifike.

9.2 Kryetari dhe anëtarët të Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve duhet të jenë shërbyes civil.

9.3 Komisioni do të jetë në përbërje prej tre (3) anëtarëve.

9.4 Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e saj i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit.

9.5 Një anëtar i Komisionit për shqyrtimin e ankesave për ndarjen e subvencioneve duhet të jetë zyrtar ligjor (jurist) i njësisë përkatëse.

9.6 Anëtarë të Komisionit për vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve nuk mund të jenë zyrtarët të cilët kanë qenë pjesë e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve.

9.7 Përbërja e Komisionit duhet të bazohet mbi parimin e barazisë gjinore.

Neni 10

Parashtrimi dhe zgjidhja e ankesave

10.1 Ankesa parashtrohet në afat prej 5 ditë pune pas njoftimit të vendimit të Kryetarit të Komunës për mos ndarjen e subvencioneve.

10.2 Komisioni duhet të bëjë shqyrtimin e ankesave dhe të marrë vendim në afat prej 15 ditë pune pas përfundimit të afatit kohor për paraqitje të ankesave.

10.3 Komisioni për ankesa gjatë vendimmarrjes vepron në bazë të ligjit për procedurën administrative dhe dispozitave të kësaj rregullore.

10.4 Vendimet e Komisionit për shqyrtimin e ankesave për ndarje të subvencioneve merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.

Neni 11

Ekzekutushmëria e vendimit

- 11.1 Vendimi i Kryetarit për ndarjen e subvencioneve bëhet i ekzekutueshëm nëse:
- 11.1.1 nuk është paraqitur ankesë sipas paragrafit 1 të nenit 12,
 - 11.1.2 me vendimin e komisionit të ankesave refuzohet ankesa.

Neni 12

Shpallja Publike për ndarjen e subvencioneve

- 12.1 Procesi i ndarjes së subvencioneve fillon përmes shpalljeve publike të cilat publikohen në ueb faqen e komunës, mediat lokale, mediat sociale vendet e frekuentuara si dhe në çdo mjet dhe vend tjetër të përshtatshëm.
- 12.2 Në shpallje përcaktohen saktë kriteret dhe procedurat për të aplikuar ndarjen e subvencioneve të cilat përcaktohen sipas kësaj rregullore
- 12.3 Shpallja publike qëndron e publikuar së paku 15 ditë nga data e shpalljes.

Neni 13

Marrëveshja për subvencionim

- 13.1 Për realizimin e subvencionit duhet të lidhet një marrëveshje me të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrat mes të komunës dhe përfituesit të subvencionit.
- 13.2 Marrëveshja duhet të përcaktojë subjektet nënshkruese të marrëveshjes, qëllimin, shumën e mjeteve financiare, afatet kohore, detyrat dhe përgjegjësitë e palëve, mbikëqyrjen, formën e subvencionimit, raportimin, hyrjen në fuqi si dhe pjesë tjera relevante për marrëveshjen.

Neni 14

Subvencionet për arsim

- 14.1 Komuna mund të ndajë subvencione për arsim duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:
- 14.1.1 bursa për student;
 - 14.1.2 bursa për nxënës në shkollë të mesme;
 - 14.1.3 bursa për nxënës në shkolla fillore;
 - 14.1.4 kuadrot deficitare;
 - 14.1.5 nxënësit me nevoja të veçanta;
 - 14.1.6 gara apo kuize (aktivitete jashtë mësimore);
 - 14.1.7 botimin e librave/revistave;
 - 14.1.8 nxënësit që kanë treguar rezultate në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
 - 14.1.9 mësimdhënësit që kanë treguar rezultate në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

14.2. Kategoritë dhe shumat e subvencioneve për bursa do të përcaktohen me vendim të veçantë të Kryetarit të Komunës, për çdo vit fiskal si dhe shumat tjera ipen me vendim të veçantë të Kryetarit të Komunës.

Neni 15

Kushtet, kriteret dhe dokumentet që nevojiten për ndarjen e bursave

15.1 Kuvendi i Komunës me vendim të veçantë përcakton kushtet dhe kriteret të qarta për dhënien e bursave duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në;

15.1.1 Fëmijëve të Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së iu ndahet bursa pa kriteret.

15.1.2 Vlerësimi kandidatëve bëhet me pikë, duke e shumëzuar notën mesatare me koeficientin 5.

15.1.3 Studentët e vitit të parë u merret nota mesatare e suksesit të shkollës së mesme të lartë dhe numri i pikëve të testit të arritshmërisë (afati i Qershorit dhe Gushtit) dhe provimet e dhëna në fakultetin përkatës.

15.1.4 Janë banorë rezidentë të Komunës së Hanit të Elezit,

15.1.5 Janë student të rregullt, por jo me vet financim,

15.1.6 Të kenë të regjistruar vitin.

15.1.7 Studenti-ja nëse një herë ka perseritur vitin, apo ndërru fakultetin humbë të drejtën e bursës (Përfshirë në këtë pikë bëjnë maturantët dhe studentët e vitit të parë të cilët për shkaqe të ndryshme nuk ka mund të regjistrohen në fakultet apo e kanë ndërru fakultetin dhe që nuk kanë marr bursë).

15.1.8 Të jetë student-e i Universitetit Publik të Kosovës.

15.1.8.1 Të jetë student në Universitetin Publik të Shqipërisë, të jetë student në Universitetin Publik të Maqedonisë Veriore .

15.1.9 Për bursë kanë prioritet studentet e vitit të dytë e më lartë, në rast se nuk plotësohet numri i studentëve që plotësojnë kriteret sipas rregullores do të plotësohet me studentët e vitit të parë

15.1.10 Një student-e nuk ka të drejtë të marrë dy apo më shumë bursa nga njësitë buxhetore apo burime të ndryshme, përjashtim ka për ato studentë që marrin bursë universitare.

15.1.11 Studenti-ja i cili ka qenë përfitues i bursës në një fakultet, nuk mund të jetë përfitues i bursës për fakultetin e dytë.

15.1.12 Studenti-ja nëse është në marrëdhënie pune nuk i takon bursa.

15.1.13 Studentët që i takojnë të njëjtës familje që plotësojnë kushtet për përfitimin e bursës atëherë të dy studentët marrin 75 % secili student. Studentët që kanë notën mesatare mbi 8.5 dhe të njëjtës familje tu epet bursa e plotë të dyve).

15.1.13 Studenti-ja nëse e ka një fakultet të përfunduar, nuk ka të drejt aplikimi për bursës.

15.2 Përveç pikëve nga paragrafi paraprak , studentëve që u takojnë kategorive të veçanta u shtohen pikë si në vijim:

15.2.1 Fëmijës së invalidit të luftës i shtohen 10 pikë.

15.2.2 Studenti-ja i cili nuk i ka të dy prindërit i shtohen 15 pikë.

15.2.3 Studenti-ja i cili ka të dy prindërit e hendikepuar i shtohen 10 pikë, dëshmi nga Mjeku librezë ose vendim.

15.2.4 Fëmijës së veteranit të luftës i shtohen 10 pikë.

15.2.5 Fëmijës së të burgosurit politikë deri në 6 muaj 5 pikë, mbi 6 muaj e me tepër 10 pikë.

- 15.2.6 Studenti-ja i cili është hendikep i shtohen 15 pikë, të dëshmohej me librezë ose vendim.
- 15.2.7 Fëmijës së martirit të luftës i shtohen 10 pikë,
- 15.2.8 Studenti-ja i cili ka njërin prind të hendikepuar i shtohen 5 pikë, dëshmi nga Mjeku librezë ose vendim.
- 15.2.9 Studenti-ja i cili e ka gjendjen e rëndë sociale i shtohen 10 pikë.
- 15.2.10 Studenti-ja me gjendje të rëndë ekonomike që me ligj largohen nga skema sociale për shkak se nuk kanë fëmijë nën moshën pesë vjeçare të u jepet përparësi njëjtë sikur se të rastet sociale i shtohen 10 pikë.
- 15.2.11 Studenti-ja i cili nuk e ka njërin prind 5 pikë.
- 15.2.12 Studenti-ja me notë mesatare 9 e mbi, vlerësohet me 20 pikë.
- 15.2.13 Studenti-ja me notë mesatare 8 e mbi, vlerësohet me 15 pikë.
- 15.2.14 Studenti-ja me notë mesatare 7 e mbi, vlerësohet me 5 pikë.
- 15.2.15 Studenti-ja i cili bënë punë vullnetare vlerësohet me 3 pikë, nëse në dy vitet e fundit shkollorë ka bërë punën.
- 15.2.16 Studenti-ja që ka marrë diploma, mirënjohje, certifikata kombëtare ose ndërkombëtare në ndonjë garë – konkurs në lëmin arsimor i shtohen 3 pikë, nëse në dy vitet e fundit shkollorë ka marrë diplomë, certifikat apo mirënjohje.
- 15.2.17 Tu jepet përparësi studentëve të cilët janë kuadro deficitare 10 pikë.

15.3 Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të bursave përfshijnë, duke mos u kufizuar:

- 15.3.1 Certifikata e notave,
- 15.3.2 Vërtetimi për vitin kalendarik të studimeve;
- 15.3.3 Deklarata e bashkësisë familjare.
- 15.3.4 Dëshmia se është invalid i luftës, se është fëmijë i dëshmorit, veteranit të luftës, martirit të luftës, se është person me aftësi të kufizuara dhe se është nga familja në skemën sociale.
- 15.3.5 Certifikatën e vendbanimit,
- 15.3.6 Diplomat, mirënjohjet, certifikatat për suksesin e arritur në gara-kurse kombëtare dhe ndërkombëtare në lëmin arsimor
- 15.3.7 Studentët që janë invalid të luftës, anëtar të familjes së dëshmorit, invalidit të luftës, veteranit të luftës, martirit të luftës, me gjendje të rëndë sociale, student me aftësi të kufizuara duhet të sjellin dëshmitë nga shoqatat librezë ose vendim dhe institucionet përkatëse.
- 15.3.8 Dokumenti i identifikimit;
- 15.3.9 Dëshmia mbi gjendjen ekonomike;

15.4 Aplikuesi nuk mund të jetë përfitues i bursës nëse brenda vitit të njëjtë fiskal ka qenë përfitues i një burse të ndarë nga pushteti qendror ose ndonjë donatorë tjetër për fushën e njëjtë.

15.5 Komuna duhet të bëjë shpalljen publike për dhënien e bursave e cila publikohet në ueb faqen e Komunës, në vendet e frekuentuara, mediat sociale dhe në media lokale.

Neni 16

Subvencionet për zhvillim ekonomik

16.1 Komuna mund të ndajë subvencione për zhvillim ekonomik duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:

16.1.1 Zejet tradicionale;

16.1.2 Aksesore;

16.1.3 Agrobizneset;

16.1.4 Teknologji Informative;

16.1.5 Ndërmarrjet publike;

16.1.6 Biznese inovative;

16.1.7 Ndërmarrje sociale;

16.1.8 Aktivitetet e shoqatave të cilat ndihmojnë dhe promovojnë zhvillimin ekonomik dhe turizmit;

16.1.9 Inkubatorët e biznesit;

16.1.10 Bizneset fillestare;

16.1.11 Aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve njerëzore për zhvillim të biznesit;

16.1.12 Aktivitetet për hulumtime të tregut të grupeve të studentëve.

16.2 Përfitues të subvencioneve për zhvillim ekonomik mund të jenë vetëm bizneset që veprojnë në Komunë.

16.3 Përfitues të subvencioneve për zhvillim ekonomik nuk mund të jenë bizneset që kanë obligime financiare të papaguara komunale dhe ATK-së.

Neni 17

Përparësitë gjatë ndarjes së subvencioneve për zhvillim ekonomik

17.1 Gjatë ndarjes së subvencioneve për zhvillim ekonomik, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi rasteve specifike në vijim:

17.1.1 Bizneseve prodhuese, përpunuese dhe shërbyese që gjenerojnë punësim;

17.1.2 Grave, të rinjve, zonave rurale, personave me nevoja të veçanta dhe komunitetet;

17.1.3 Bizneset që kanë siguruar bashkëfinancim nga palë të treta prej 90 % (të përcaktohet vlera minimale) të vlerës;

17.1.4 Bizneset të cilat posedojnë dëshmi apo certifikime profesionale.

17.1.5 OJQ-të të cilët aplikojnë me projekte biznesi të cilat mundësojnë gjenerim të vendeve të punës.

17.1.6 Bizneseve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga komuna dhe gjatë vitit të njëjtë fiskal nuk kanë qenë përfitues i një subvencioni për zhvillim ekonomik të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër.

17.1.8 Bizneset e përcaktuara në paragrafin 1.3 dhe 1.4 të këtij neni mund të aplikojnë për ndarje të subvencioneve edhe jashtë periudhës së shpalljes publike me kërkesë të arsyetuar.

Neni 18

Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për e subvencione- për zhvillim ekonomik

18.1 Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për zhvillim ekonomik përfshijnë, duke mos u kufizuar:

18.1.1 Plani i biznesit;

18.1.2 Dokumenti identifikues;

18.1.3 Certificate e vendbanimit (për persona fizik);

18.1.4 Certificate e biznesit;

18.1.5 Dëshmi për pagesën e taksave komunale;

18.1.6 Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;

18.1.7 Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së;

18.1.8 Dëshmi për bashkëfinancim (nëse ka bashkëfinancim);

19.1.9 Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;

Neni 19

Subvencionet për bujqësi

19.1 Komuna mund të ndajë subvencione për bujqësi duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:

19.1.1 projekte të fermerëve, shoqatave, kooperativave bujqësore, në fushat bujqësore me prioritet për Komunën;

19.1.2 organizimin e panairëve, seminareve, vizitave studimore;

19.1.3 mbështetjen e projekteve me bashkëfinancim;

19.1.4 projekteve në sektorin e pylltarisë.

19.2 Gjatë ndarjes së subvencioneve në bujqësi, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi:

19.2.1 Zonave me prioritet të identifikuar nga Komuna;

19.2.2 Pjesëmarrjes së fermerit në bashkëfinancim prej 10 % *(të përcaktohet vlera minimale)* të vlerës, me përjashtim kur në ftesën publike është përcaktuar ndryshe;

19.2.3 Grave, të rinjve, personave me nevoja të veçanta dhe minoritetet;

19.2.4 Aplikantëve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga komuna dhe gjatë vitit të njëjtë fiskal nuk kanë qenë përfitues i një subvencionit për bujqësi të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër.

Neni 20

Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione në bujqësi

20.1 Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për bujqësi nga personat juridik përfshijnë, duke mos u kufizuar:

20.1.1 Numri identifikues i fermerit (NIF);

20.1.2 Certifikata e biznesit;

20.1.3 Projekti dhe plani financiar;

20.1.4 Fletëposedim për patundshmëri;

20.1.5 Dëshmi për pagesën e taksave komunale;

20.1.6 Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;

20.1.7 Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së;

20.1.8 Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;

20.1.9 Dokumenti identifikues i personit të autorizuar për tërheqjen e mjeteve dhe autorizimit.

20.1.10 Dëshmi se nuk është përfitues i një subvencionit të ndarë nga pushteti qendror në këtë fushë brenda vitit fiskal.

20.1.11 Dëshmia për pjesën e bashkëfinancimit

20.2 Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për bujqësi nga personat fizik përfshijnë, duke mos u kufizuar:

20.2.1 Numri identifikues i fermerit (NIF);

20.2.2 Projekti dhe plani financiar;

20.2.3 Fletëposedim për patundshmëri;

20.2.4 Dëshmi për pagesën e taksave komunale;

20.2.5 Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;

20.2.6 Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;

Neni 21

Subvencionet për shëndetësi dhe mirëqenie sociale

21.1 Komuna ndanë subvencione për banorët rezident dhe jorezident në raste të veçanta për përballimin e shpenzimeve të shërimit sipas kritereve të përcaktuara nga drejtoria përgjegjëse për shëndetësi.

21.2 Subvencionet për shëndetësi jepen për:

21.2.1 rastet e rënda shëndetësore e konstatuar me dokumentacion mjekësor të specialistit;

21.2.2 rastet e sëmundjeve jo të rënda por pa burim të të ardhurave;

- 21.2.3 trajtimi jashtë vendit;
- 21.2.4 lehona;
- 21.2.5 fushatat e vetëdijesimit për shëndetin publik;
- 21.2.6 mirëqenie sociale
- 21.2.7 shërbimet sociale.

21.3 Gjatë ndarjes së subvencioneve në shëndetësi, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi rasteve specifike në vijim:

- 21.3.1. Numri i anëtarëve të familjes;
- 21.3.2 Çështja e banimit;
- 21.3.3 Kostoja e trajtimit;
- 21.3.4 Gjendja ekonomike familjare;
- 21.3.5 Trajtimi në institucionet private (nëse një sëmundje e tillë nuk mund të trajtohet në institucionet publike).

21.4 Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për shëndetësi nga personat fizik përfshijnë, duke mos u kufizuar:

- 21.4.1 Diagnoza e mjekut specialist;
- 21.4.2 Dokumenti i identifikimit;
- 21.4.3 Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;
- 21.4.4 Dëshmia e shpenzimeve mjekësore.
- 21.4.5 Personat, për subvencionet e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni mund të ndahen edhe pa shpallje publike por me kërkesë të arsyetuar

Neni 22

Subvencionet për kulturë, rini, sport

22.1. Komuna mund të ndajë subvencione për kulturë, rini dhe sport duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:

- 22.1.1 Klubet sportive
- 22.1.2 Sportistët e dalluar
- 22.1.3 Garat sportive
- 22.1.4 Shoqëritë amatore (ansamblet)
- 22.1.5 Teatrot amatore
- 22.1.6 Festivalet
- 22.1.7 Botimi i librave
- 22.1.8 Ekspozitat me fotografi
- 22.1.9 Aktivitete me karaktere garuese
- 22.1.10 Pjesëmarrje në festivale jashtë komune
- 22.1.11 Promovim i librave
- 22.1.12 Promovim i talentëve të rijë
- 22.1.13 Aktivitete, kulturore, rinore dhe sportive të organizuara nga DKRS
- 22.1.14 KVRL
- 22.1.15 Qendra Rinore
- 22.1.16 OJQ

22.2 Gjatë ndarjes së subvencioneve, në kushte të barabarta, Komuna u jep përparësi rasteve specifike në vijim:

- 22.2.1 Projektet që kanë siguruar bashkëfinancim nga palët e treta sipas vlerës;
- 22.2.2 Projektet të cilat mund të gjenerojnë të hyra financiare për kërkuesin e subvencionit, në funksion të sigurimit të qëndrueshmërisë së projektit për periudhën e ardhshme;
- 22.2.3 Aplikantëve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga komuna dhe gjatë vitit të njëjtë fiskal nuk kanë qenë përfitues i një subvencionit për kulturë, rini, sport të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër

22.3 Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve përfshijnë, por duke mos u kufizuar:

- 22.3.1 Projekt propozimi;
- 22.3.2 Aplikacioni;
- 22.3.3 Dokumenti identifikues;
- 22.3.4 Certificate e vendbanimit (për persona fizik);
- 22.3.5 Certificate e regjistrimit (për persona juridik);
- 22.3.6 Dëshmi për pagesën e taksave komunale;
- 22.3.7 Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë (për persona fizik);
- 22.3.8 Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së (për persona juridik);
- 22.3.9 Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;

Neni 23

Raportet kthyes nga përfituesit e subvencioneve

23.1 Përfituesit e subvencioneve të ndara nga Komuna obligohen që në Komunë të dorëzojnë raport financiar dhe narrativ (te detajuar).

23.2 Përfituesit e subvencioneve obligohen që pas marrjes së subvencionit të dorëzojnë në komunë raportin me të gjitha shpenzimet financiare ashtu siç janë kërkuar me projekt-propozim. Raporti duhet t'i ketë të gjitha shpenzimet e dokumentuara (raportet bankare, faturat e rregullta, nënshkrimet e pjesëmarrësve etj.).

23.3 Përfituesit e subvencioneve obligohen që pas përfitimit të subvencioneve të dorëzojnë raportin narrativ (te detajuar) i cili duhet t'i ketë të gjitha të dhënat e aktiviteteve që janë realizuar gjatë zbatimit të projektit.

23.4 Periudha kohore e raportimit duhet të jetë 30 ditë pas përfundimit të afatit kohor të përcaktuar në marrëveshjen në mes palës përfituese dhe komunës

23.5 Raportet nga paragrafi 1 i këtij neni protokollohen dhe një kopje e tyre dorëzohet në arkivin e komunës.

Neni 24
Monitorimi i përfituesve të subvencioneve

24.1 Komuna ka të drejtë të iniciojë auditimin e përfituesve për mënyrën e shpenzimit të mjeteve të ndara nga komuna në formë të subvencioneve.

24.2 Komuna mund të bëjë monitorimin e përfituesve të subvencioneve, me theks të veçantë të përfituesve në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit ekonomik, në lidhje me shfrytëzimin e drejtë dhe sipas vendimit apo marrëveshjes të mjeteve të ndara në formë të subvencioneve.

24.3 Monitorimi sipas paragrafit 2 mund të bëhet në periudhën kohore deri në 3 vite nga data e përfitimit të subvencionit.

Neni 25
Transparenca në ndarjen e subvencioneve

25.1 Komuna publikon listën përfundimtare të përfituesve të subvencioneve brenda 2 ditë pune pas vendimit për ndarje të subvencioneve nga Kryetari.

25.2 Lista përfundimtare e përfituesve duhet të përmbajë: emrin e përfituesit, rastin, fushën për të cilën jepet subvencioni dhe shumat që iu janë ndarë

25.3 Përfundimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, komuna nuk i publikon subvencionet për rastet e përcaktuara në paragrafët 2.1, 2.2, 2.3, të nenit 21.

25.4 Publikimi i vendimeve dhe i përfituesve nga ndarja e subvencioneve bëhet në ueb-faqen e Komunës, në tabelat e shpalljeve si dhe në vendet e frekuentuara në territorin e Komunës.

Neni 26
Dispozitat transitorë dhe shfuqizuese

26.1 Ndarja e subvencioneve e filluar para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje vazhdon me rregullativën ekzistuese pavarësisht nëse kjo rregullore hyn në fuqi.

26.2 Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet rregullorja për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve me numër 01/4805/2018 e datës 30.08.2018.

Neni 27
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës

Hani i Elezit
Data: 30.09.2024





PREPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



11/Nr 7558/2026

DATA:	05.08.2026
PËR:	KPF-së dhe Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit
PËRMES :	Mehmet Ballazhi, Kryetar i Komunës
NGA :	Abduraman Bushi, Drejtore i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
LËNDA:	Informatë mbi korrje-shirjet për vitin 2026

*Me anë të kësaj shkrese informoj **KPF-në** dhe **Kuvendin Komunal** se fushata e **korrje-shirjeve** për vitin 2026 në Komunën e Hanit të Elezit është zhvilluar relativisht mirë edhe përkundër autokombajnave të vjetruara dhe terrenit kodrinorë malorë.*

Informatë më të zgjeruar rreth procesit të korrje-shirjeve e kemi paraqitur në faqen tjetër.

Të dhënat e realizimit të korrje-shirjeve në Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2026

<i>Komuna – Hani i Elezit</i>	Viti 2026	Viti 2025
<i>Data e fillimit të korrje-shirjeve</i>	05.07.2026	25.06.2025
<i>Data e mbarimit të korrje-shirjeve</i>	15.07.2026	08.07.2025
<i>Sipërfaqet e korrura me grurë</i>	46.5 ha	40 ha
<i>Sipërfaqet e korrura me elb</i>	6.22 ha	6.6 ha
<i>Sipërfaqet e kositura me thekër</i>	0.38 ha	0.70 ha
<i>Sipërfaqet e kositura me tërshërë</i>	14.87 ha	9.7 ha
<i>Rendimenti mesatar i grurit kg/ha</i>	3,700 kg/ha	4,000 kg/ha
<i>Rendimenti mesatar e elbit kg/ha</i>	3,300 kg/ha	3,500 kg/ha
<i>Çmimi i korrje-shirjeve euro/ha</i>	150 €	150 €
<i>Sipërfaqe të korrura</i>	52.72 ha	46.6 ha
<i>Gjithësej të mbjelura</i>	67.97 ha	57 ha
<i>Numri i autokombajnave</i>	1	2